



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Assoc. Dr. Bujar Dida
2. Dr. Merita Stafasani

Nëntor/ 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Kimi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kimisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Kimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrisë së Arsimit Nr 31 datë 30.12.1994
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASh Nr.297 dt 20.07.2012.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	S’ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (v.a 2021- 2022)	33/ 13
18	Numri i studentëve: (3 vitet e fundit akademike)	182 student
19	Komente/ të tjera:	

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Kimi” është një program studimi i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), pranë Universitetit të Tiranës (UT). Njësia përgjegjëse për këtë program është Departamenti i Kimisë (DK).

Në nivel kombëtar ky PS është unik, nga tradita dhe eksperiencia në IAL e vendit tonë. Ai është hartuar dhe organizuar në përputhje me misionin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Universitetit të Tiranës dhe synon përgatitjen dhe diplomimin e studentëve në fushën e kimisë në përputhje me nevojat e tregut të punës, në shërbim të zhvillimeve dinamike në nivel kombëtar, rajonal e më gjerë dhe përshtatet mjaft mirë me përcaktimet në Vendimin Nr. 514, date 20.9.2017, nën emërtesën “Kimist” me kodin e profesionit 2113.

GVJ bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit pranë ASCAL në formë elektronike dhe të printuar, si dhe evidentuar gjatë vizitës në institucion konkludon se struktura dhe organizimi i PS është në përputhje me legjislacionin në fuqi, referuar Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe VKM nr 41/ 24.01.2018. Kreditet e lëndëve, objektivat e studimit, pritshmëritë e aktiviteteve formuese dhe ngarkesat respektive në orë mësimore, janë të paraqitura në sillabuse të modeleve përkatëse.

Programi i studimit është i ndërtuar mbi bazën e kritereve dhe standarteve referuar tipologjisë së lëndëve, si dhe ngarkesës së orëve dhe krediteve me një shpërndarje korrekte dhe uniforme të tyre. Programi i Studimit Bachelor në “Kimi” është i organizuar në tre vite studimi, gjashtë semestra ku zhvillohen gjithsej 30 lëndë prej të cilave 26 janë detyrueshme. Gjatë ciklit zhvillohen dhe katër lëndë me zgjedhje që përzgjidhen nga studentët në mes 9 lëndëve të prezantuara. Programi i studimit finalizohet me provimin e diplomës, i cili vlerësohet me 4 kredite. Numri total i krediteve të grumbulluara është 180.

Stafi drejtues dhe pedagogët përbëhen nga personeli akademik dhe ndihmës, që punojnë me kohë të plotë dhe të përfshirë në aktivitetin kërkimor shkencor që garanton vijimësinë afatgjatë të burimeve akademike. Në programin e studimit përfshihen edhe staf akademik nga departamente të tjera të UT/FSHN, si dhe staf akademik me kontratë PAK. Stafi akademik efektiv karakterizohet nga një nivel i lartë i kualifikimit shkencor, por edhe stafi PAK është i mirëpërzgjedhur e në përshtatshmëri të plotë me lëndët që mbulojnë.

Gjithë veprimtaria e Departamentit të Kimisë dhe realizimi i programit mësimor bazohet në rregullore dhe dokumentacion të përditësuar, transparent dhe të bërë publik për të gjithë të interesuarit.

Departamenti shqyrton dhe vlerëson në mënyrë periodike kurikulën e programit të studimit dhe bën ndryshimet e nevojshme në përputhje me aktet ligjore, Statutin dhe rregulloret e institucionit. Këto ndryshime marrin në konsideratë zhvillimet bashkëkohore të shkencës së kimisë dhe i shërbejnë formimit të studentit me kompetenca dhe aftësi në përputhje me kërkesat e tregut të punës, të cilat sipas studimeve të tërthorta të kryera, për studentët e këtij programi nuk janë të pakta si në sektorin e arsimit publik dhe privat, në institucione të ndryshme publike si dhe në subjekteve private të sektorit të industrisë dhe ushqimit.


GVJ konfirmon se infrastruktura e DK është e përshtatshme për sigurimin e realizimit të plotë dhe cilësor të programit të studimit. Klasat dhe auditorët janë të rikonstruara dhe të mirëpajisura me mjete audivizive dhe internet në të gjitha ambjentet. Departamenti i Kimisë

ushtron aktivitetin e tij mësues dhe shkencor në laboratore të pajisura me aparatura bashkëkohore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga GVB, takimi me studentët dhe përfaqësuesen e DSBCK, GVJ vlerëson se IAL vë në dispozicion të informimit të studentëve për ecurinë e programit, mundësitë e punësimit dhe të drejtat dhe detyrimet ligjore etj., gjithë strukturat mbështetëse të DK dhe UT/FSHN, si dhe faqet zyrtare të web. IAL përfshin studentët në organet vendimarrëse e këshilluese, në rishikimin e programeve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies etj., nëpërmjet pjesëmarrjes në komisionet e parashikuar në LAL dhe statutin e UT, si dhe plotësimin e pyetësorëve të hartuar nga DSBCK.

Sistemet e sigurimit të cilësisë, sistemet e informacionit, të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës janë funksionale dhe plotësojnë kushtet optimale në shërbim të një programi që plotëson standartet dhe kriteret e përcaktuara.

Në përfundim, GVJ vlerëson se Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Kimi” i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), pranë Universitetit të Tiranës (UT) me njësi përgjegjëse për programin, Departamentin e Kimisë (DK), i përmbush standartet plotësisht në të gjitha fushat dhe nivelet përkatëse të secilës fushë.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Raporti i vlerësimit të jashtëm për programin e ciklit të parë Bachelor në “Kimi”, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës është hartuar nga grupi i punës i përbërë nga një pedagoge e Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe një pedagog i Universitetit Politeknik të Tiranës, të profileve Kimi. Ky raport u hartua nga shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës të vënë në dispozicion nga institucioni pranë ASCAL me qëllim akreditimin e Programit të Studimit (PS) të Ciklit të Parë Bachelor “Kimi”, si dhe gjetjet e GVJ-së nga vizita konkrete dy ditore në Departamentin e Kimisë (DK) dhe nga takimet me stafin akademik, studentët dhe përfaqësues të zyrave të ndryshme (sipas agjendës së miratuar paraprakisht), që kontribuojnë në mbarëvajtjen e punës dhe në ecurinë e PS.

Në hartimin e raportit, grupi ka vepruar me detyra dhe përgjegjësi të qarta, duke u bazuar në kërkesat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë, si dhe aktet ligjore dhe nën ligjore që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm, duke vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, nivelin dhe performancën e personeli akademik, vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion etj. Pavarësisht punës tepër voluminoze, procesi i ndërtimit të raportit rezultoi tepër i vlefshëm. Ky proces shërbeu jo vetëm për njohjen më nga afër të çështjeve të ndryshme, por edhe për rritjen e mëtejshme të cilësisë së fushave të këtij programi studimi.

Mbi bazën e dokumentacionit të shqyrtuar dhe informacionit të vjelë nga takimet janë bërë vlerësimet për përmbushjen e të gjitha kërkesave që lidhen me plotësimin e kriterëve të standardeve të vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më realisht situatën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Assoc. Dr Bujar Dida dhe Dr. Merita Stafasani. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Aviola Bardhi, Koordinatorë Teknike e ASCAL.

Grupi u njoh dhe shqyrtoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me agjendën e vizitës në institucion.

Më datë 24/10/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/132 Prot., datë 24/10/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. UT kthehu përgjigje me shkresë zyrtare Nr. 1626/33 Prot., datë 16/11/2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi”


I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Kimi” i ofruar nga Departamenti i Kimisë (DK) nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është zhvilluar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, treguar edhe në evidencën 1.1 dhe evidencën 1.2. Programi është i ndërtuar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë, Statutit të Universitetit të Tiranës dhe synon përgatitjen e kimisteve për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës.			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit bachelor në “Kimi”, sipas përcaktimeve në statutin e Universitetit të Tiranës (evidencën 1.1) dhe Rregullores së Departamentit të Kimisë (evidencën 1.3.) ruan dhe konsolidon vlerat akademike dhe kombëtare me promovimin e njohurive të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor bashkohor dhe në shërbim të formimit sa më të plotë të studenteve për fushën e kimisë.			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni i institucionit (UT/ FSHN) dhe fusha e veprimtarisë janë evidentuar me evidencat 1.1 (tre nivele studimi), dhe evidencën 1.3. (misioni dhe objektivat e DK) dhe janë në përputhje të plotë me misionin e UT. Programet ofrohen në tre cikle; ciklin e parë Bachelor, ciklin e dytë Master dhe ciklin e tretë Doktoraturë në njëdise mësimore të përshtatshme dhe me një qasje bashkëpunuese të personelit akademik shkencor për të promovuar zhvillimin e të gjithë cikleve dhe inkurajimin e studenteve për të synuar deri në studimet e ciklit të tretë.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit është hartuar dhe ofron nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal/ kombëtar në përputhje me argumentat e paraqitura në evidencën 1.2 dhe 1.4. Për këtë pjesë e programit është bashkëpunimi për kërkimin shkencor me biznesin, me arritjet teknologjike rajonale dhe bashkëpunimin me institucione publike dhe private në qasje me tregun e punës lokal dhe rajonal.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2


Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
----------	------------------------	--	--	--



Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me zbatimin e strategjisë të zhvillimit institucional të Universitetit të Tiranës (evidenca 1.1, evidenca 1.2 dhe evidenca 1.4). Në dokumentacionin e paraqitur për mbështetje, programi i studimit paraqet vizionin dhe misionin e Universitetit të Tiranës dhe strategjinë e zhvillimit të programit në Departamentin e Kimisë.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Programi i studimit është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me Statutin (evidenca 1.1) dhe Rregulloren e UT-se (evidenca 1.5) dhe Rregulloren e DK (evidenca 1.3).			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit në emërim dhe kredite ECTS (sipas fushës së studimit të Shkencave Natyrore, evidenca 1.1), organizim (lëndet ndahen në lëndë bazë (A), karakterizuese (B), ndërdisiplinore/integruese (C), plotësuese (D) dhe detyrime përmbyllse (E) evidenca 1.5) dhe përmbajtje (sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, evidenca 1.6).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që fitojnë studentët përgjatë dhe në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit janë paraqitur qartësisht në Misionin e DK (evidenca 1.3), në çdo syllabus (evidenca 1.7) dhe programin e lëndëve të programit të studimit Bachelor Kimi (evidenca 2.1). Studenti mund të nihet me çfarë ofron programi, përveç dokumentave të evidentuara me sipër edhe në faqen Web të Departamentit të Kimisë, ku janë pasqyruar qëllimi, objektivat, dijet që fitohen, kreditet, syllabuset etj.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre,	Studimi mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës që ofron programi i studimit, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike është pasqyruar dhe argumentuar në mënyrë të detajuar përmes. Në mënyrë specifike pasqyron shifrat e tregut të punës dhe tendencën, deri në mundësinë e punësimit, dhe në veçanti mundësinë e punësimit si PAE Shifrat e këtij sektori ndiqen dhe përditësohen nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) që funksionon pranë FSHN. evidencave 1.8 – 1.9; evidencave 1.9; evidenca 1.10.




mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.									
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Studimi mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës që ofron programi i studimit, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike është pasqyruar dhe argumentuar në mënyrë të detajuar përmes evidencave 1.8 – 2.9. Në mënyrë specifike evidenca 1.9 pasqyron shifrat e tregut të punës dhe tendencën, deri në mundësinë e punësimit si edhe në veçanti mundësinë e punësimit si PAE (evidenca 1.10). Shifrat e këtij sektori ndiqen dhe përditësohen nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) që funksionon pranë FSHN.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	UT demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar (evidenca 1.2) dhe FSHN zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me standardet (Tabela 16 ASCAL), ka në përbërje 8 departamente dhe një qendër kërkimore (evidenca 1.14). Departamentet e FSHN plotësojnë kushtin e PAE me kohë të plotë nga të cilët vetëm 3 janë pa grada shkencore/tituj akademike (tabela 1 ASCAL). Programi i studimit afrohet nga personeli akademik i kualifikuar (evidenca 1.15), prej 30 pedagogësh të punësuar me kohë të plotë (evidenca 1.16) me titullare lënde në përputhje me kualifikimin dhe kontributin (evidencë 1.6, 1.16), me grup lëndësh dhe personeli akademik ndihmës sipas evidencave 1.12 dhe 1.17.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Kontributi shkencor në lidhje dhe në përputhje me dinamikën e rritjes së cilësisë së programit të studimit është evidentuar me bashkëpunimin me personeli akademik të jashtëm (evidenca 1.18, 1.19 dhe 1.20) me fusha të kërkimit shkencor (evidencat 1.1, 1.5) në përputhje me programin e studimit (evidenca 1.16) dhe me qasje të plotë me kuadrin e bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe BE.

<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë DK (evidenca 1.4), që është përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit (evidenca 1.6), niveli 6, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane që lejojnë transferimin apo vijimin e studimeve në IAL të tjera brenda vendit (evidenca 1.21, 1.21.1) dhe jashtë vendit (evidencat 2.20-2.29 dhe 5.23).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Hartimi, mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit sigurohet përmes marrëdhënieve të bashkëpunimit brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, sipas Statutit të UT (evidenca 1.1), miratimit të kuotave (evidenca 1.22, 1.23) dhe ndjekjes (evidenca 1.24). Përgjegjësitë respektive realizohen përveç sa më sipër edhe ndërmjet komisioneve, transferimeve dhe ekuivalentimeve (evidenca 1.1, 1.21, 1.21.1) punësimit të personelit akademik (evidencat 1.26, 4.28.1), kërkesave buxhetore (evidenca 1.27), me miratimet përkatëse nga dekanati (evidenca 1.28).</p> <p>Analiza e vazhdueshme e procesit kryhet në raportet vjetore të njësisë kryesore (evidenca 1.29), të hartuara nga njësitë bazë (evidencat 6.7, 6.9, 6.10).</p> <p>Këshillat studentore (evidenca 1.1) dhe Komisioni për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhëniet me studentët (evidencat 1.30 dhe 1.31) realizojnë pjesëmarrjen e studentëve në proces.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>UT, respektivisht FSHN dhe DK kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe</p> <ul style="list-style-type: none"> - brenda vendit: bashkëpunime me rrjetin universitar vendor (evidenca shtesë e paraqitur nga GVB, pas takimeve të realizuara nga GVJ), projekti Nanoalb (evidenca 1.29), bashkëpunimi me Institutin e Fizikes Berthamore të Zbatuar (evidenca 1.19) etj - jashtë vendit: Programi Erasmuss (evidenca 2.32) me 42 marrveshje dhe 100 universitete, projekti NETCHEM (evidenca 1.32) si edhe projekte të tjera të pasqyruara në evidencat 4.13-



	4.15, evidencat 1.33-1.36), bashkëpunime shkencore (evidencat 1.29, 6.7, 6.9, 6.10) - me aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj: trajnime dhe intershipe (evidenca 1.29, 1.37, 2.37). Marrëdhëniet e bashkëpunimit janë të mirëdokumentuara.			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	DK në mënyrë periodike ka përgatitur raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve (evidencat 1.29, 1.38, evidencat 6.7, 6.9, 6.10). Dhe këto raporte (analiza) janë përdorur dhe përdoren për vlersimin e ecurisë së programit dhe ndryshimeve të justifikuara që duhet të pësoje si pasojë e ndërveprimit me kërkesën dhe ofertën.			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	DK ka vendosur marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë dhe e ka mirëdokumentuar bashkëpunimin (evidencat 1.27, 1.29, 1.37, 2,36). Bashkëpunimi ka përfshirë biznese përfaqësuese të Listes Kombëtare të Punësimit dhe qasja e diskutimeve dhe ndërveprimi ka synuar në përshtatjen sa më të mirë të programit me përdorimin e njohurive të fituara.			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	DK ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit e dokumentuar në evidencat respektive (evidencat 1.29, 1.32, 1.34, 1.39, 1.40, 4.15, 6.9) duke realizuar workshope dhe diploma. Keto bashkëpunime të evidentuara sa me sipër përveçse në kuadrin lokal janë organizuar edhe në kuadër rajonal si me programet NETCHEM (Erasmus+).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 si dhe VKM Nr. 41 të MASR, Dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018, evidencat 1.1, 1.5, 1.6)) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (evidenca 2.1)
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit të ciklit të parë “Kimi” synon në formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. (evidenca 1.3, 1.7, 2.1).
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Kimi” transmeton njohuri të përparuara (evidencat 1.6, 2.1) për fushat e studimit ose punësimit, pasi përfshin të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës në përputhje me përcaktimet në Vendimin Nr. 514, date 20.9.2017, nën emërtesën “Kimist” me kodin e profesionit 2113.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Kimi” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale: <ul style="list-style-type: none"> - Me lëndët bazë (A) dhe lëndët karakterizuese (B) ofrohen njohuri të përparuara për fushën (evidencat 1.6, 2.1); - Përmes seancave laboratorike studenti përvetëson dhe zhvillon aftësitë eksperimentale kërkuese (evidenca 2.2, 2.3, Tabela 13 ASCAL) në 34 laboratorve (evidenca 1.12, 4.10); Me praktikën dhe intershipin studenti qaset me tregun e punës (evidencat 1.7, 1.29, 1.37, 2.36, 2.37).
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi nuk ka mungesa dhe përmban të gjitha elementet në strukturën e programit të studimit të përcaktuara sipas akteve ligjore e nënligjore të evidentuara në organizimin (evidenca 1.7), rregulloren (evidenca 2.4), personelin akademik me të dhënat respektive (evidencat 1.15, 1.18, 2.5, 2.6, 2.7), planin mësimor (evidenca 1.6), programet e lëndëve (evidenca 2.1) dhe suplementit të diplomës (evidenca 2.8).
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi e ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 11

grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite dhe kjo shprehet në evidencën 1.6.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	UT/ DK përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Është themeluar me VKM Nr. 207, datë 30.05.1957, funksionon me statut (evidenca 1.1) dhe rregulloret përkatëse (evidenca 1.3, 1.5) dhe me personel akademik 30 pedagogë me kohë të plotë ku 26 janë me grada dhe tituj (Tabela 1 ASCAL). UT është akredituar më parë (evidenca 1.8 dhe 2.9) VBA Nr. 84, date 27.10.2018.
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	UT/ DK përgjegjëse për programin ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij (evidencat 1,3 dhe 1.5). Koordinatori i programit në DK është Përgjegjësi i Departamentit (evidenca 1.3). Përgjegjësi i Departamentit/ Koordinatori i bashkërendon punët me Përgjegjësi/ Titullari i Grup- Lëndëve (evidencat 1.1, 1.5, 2.10). Përgjegjësi i Departamentit mbikqyr veprimtaritë mësimore dhe kërkimore/ shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor e akademik të personelit akademik (evidencat 6.7, 6.9, 6.10), pas raportimeve në analizën vjetore të tij (evidenca 1.5). Përgjegjësi/ Titullari i Grup-Lëndëve ndjek aktivitetin mësimor (evidencat 2.11, 2.12) dhe shkencor të stafit akademik dhe ndihmës akademik të grupit dhe raporton tek Përgjegjësi i Departamentit realizimin e programit mësimor dhe kërkimor.
Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	UT/ FSHN ku DK është përgjegjëse për programin e studimit përmbush plotësisht, detyrimet ligjore (evidenca 2.14, 2.15) dhe nënligjore për organizimin (evidenca 2.13, dhe strukturën akademike (evidencat 1.1, 2.4, 1.14, 1.23) dhe Tabela 3 ASCAL). FSHN përbëhet nga 8 departament dhe secili departament përmbush detyrimet ligjore në përbërjen e strukturës akademike.
Kriteri 4. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	UT/ FSHN (Tabela 1 ASCAL) dhe DK përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (Tabelat 1,2 ASCAL). Viti akademik 19-20: 29 PAE (9 Prof; 6 Prof As; 10 Dr; 4 Msc) dhe 21 PAK (5 Prof; 3 Prof As; 8 Dr; 6 Msc) Viti akademik 20-21:

	29 PAE (9 Prof; 8 Prof As; 9 Dr; 3 Msc) dhe 15 PAK (4 Prof; 3 Prof As; 5 Dr; 4 Msc)			
	Viti akademik 21-22: 30 PAE (11 Prof; 8 Prof As; 7 Dr; 4 Msc) dhe 14 PAK (2 Prof; 3 Prof As; 4 Dr; 5 Msc)			
Kriteri 5. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Struktura akademike e FSHN është sipas detyrimeve ligjore dhe nënligjore (evidencat 1.1, 2.4). DK është përgjegjëse për programin e studimit përmbush plotësisht, detyrimet ligjore të organizimit dhe strukturimit në fushë studimi, grup-lëndë, kohëzgjatje dhe transferim studimesh, diplomim dhe suplement diplome (evidenca 2.16, 1.21, 2.8).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	UT/ FSHN/ DK, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin (evidenca 1.1, 1.5, 1.3), strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimeve (evidenca 1.6, 2.1, 2.5, 2.6, 1.23, 2.8 dhe Tabela 4 ASCAL).
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi (VKM Nr. 41. Dt. 24.01.2018) <i>Por pavarësisht se ruhen tipologjitë e lëndëve, nga shqyrtimi i evidencës 1.6 dhe tabelën 9 ASCAL vërehet që përqindja në % kundrejt totalit 180 të krediteve për kategoritë nuk janë në përshtatshmëri me limitet e përcaktuara nga VKM Nr. 41. Dt. 24.01.2018.</i> <i>Kështu kreditet për lëndët e tipit A zënë 20%, të tipit B 57.8%; të tipit C 15%; të tipit D 4.4% dhe të tipit E vetëm 2.2%. Siç shihet lëndët e tipit B e tejkalojnë limitin 55% që përcakton VKM 41(50-55) dhe së bashku me ato të tipit A vënë 77.8 % (limiti jo më pak se 70 %) por ky tejkallim shkon në raportet e ulëta për lëndët e tipit D. Edhe kreditet e vendosura për provimin e diplomës janë të ulëta dhe mendojmë që duhet të jenë jo më pak se 6 kredite.</i> <i>Mendojmë që ky kriter nuk plotësohet ndaj duhen rishikuar vlerësimet në kredite për tipologjitë e lëndëve deri në përmbushjen e kërkesave të VKM 41. dt. 24.01.2018.</i>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi është i organizuar në lëndë, module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 13


vlerësuar me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. Organizimi me i detajuar i studimit është në zbatim dhe përputhje të plotë me kuadrin ligjor (evidencat 1.7, 2.4, 2.13 dhe Tabela 9, 10 ASCAL) me kredite të ndara 60 per vit akademik dhe gjithsej 180 kredite ECTS.			
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi është i plotësuar në tërësi me dokumentacionin e planit mësimor (evidenca 1.6), ku janë përfshirë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore (evidenca 2.1, 4.1), orët në auditor/ jashtë auditorit (evidenca 2.17, 2.18), frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.			
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit (evidenca 2.4, 1.23), transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve . (evidenca 1.5, 2.4).			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi përmban të gjitha informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara, evidenca 2.1) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Tabela 14 ASCAL			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Ka dokumentim të qartë që përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. (evidenca 1.3, 1.6, 2.19 dhe tabela 11 ASCAL).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në	Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi:

përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL”; - VKM Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL” - Kornizën Shqiptare të kualifikimeve që janë reflektuar në program (evidenca 1.6).
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Programi në emërtim, përmbajtje të veprimtarive, në shpërndarjen e lëndëve dhe praktikave mundëson, njohuri (evidenca 1.6), aftësi dhe/ose punësim të studentëve (evidenca 1.10) në përputhje me përcaktimet në Vendimin Nr. 514, date 20.9.2017, nën emërtesën “Kimist” me kodin e profesionit 2113, evidenca 2.2, 3.21, Tabela 13 ASCAL).
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Programi (evidenca 2.1) në formulim dhe zbatim lëndët/ modulet, shpërndarjen në vite e semestra, vlerësimin në kredite e orë mësimore (evidenca 1.6, Tabela 9 ASCAL) plotëson arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit (evidenca 1.6) për tre vite përmban respektivisht 12, 8, dhe 11 lende, totali 31 lende, nga të cilat gjashtë lende janë të grupit A, 13 janë të grupit B, katër të grupit D, shtatë të grupit C dhe provimi i diplomës në grupin E. Shpërndarja e krediteve është e balancuar me ngarkesën e studentit dhe grupin e lendes. Ka lende të grupit A që janë ndare në dy semestra me një total kreditesh nga 13 në 10, ndërsa lendet e grupit C janë me kredite nga 5 në 3 ku kryesisht me 3 kredite dhe me vlerësim vjetor janë lendet me zgjedhje. Struktura e programit (evidenca 1.6), lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori -praktikë (Tabela 9, 10, 13. ASCAL) është në përputhje me profilin e programit bachelor. Emertesa e lendëve dhe kreditet të përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare duke mundësuar transferimin e krediteve nëse kërkohet.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Veprimtaritë formuese (evidenca 1.6 Tabela 20 ASCAL) të lendëve baze (A) me përgatitjen metodologjike dhe formimin e përgjithshëm ze 36 kredite ose 20% të programit ndërsa lendet karakterizuese (B) zënë 104 kredite ose 57 % të programit dhe së bashku janë 77% e tij (≥70 %). Nga përmbajtja, raportet e formimit teorik dhe praktik studentit në përfundim të studimeve mund të punësohet mbështetur në kërkesat e tregut të punës (evidenca 1.10). Por gjithashtu mund të transferojë ose të ketë mobilitet pasi DK ka krijuar lidhje dhe kontakte për realizimin e një kerkese të tillë (evidenca 2.30, 2.31, 2.32).
Kriteri 6. Programet e lëndëve/ moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi syllabuset e lëndëve/ moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit e treguar qartë kjo në dokumentacionin e paraqitur (evidenca 2.1) ku në literaturën përkatëse të syllabusit janë botime të 5 viteve të fundit., Në



	(evidencat 2.19, 2.34, 3.25) është paraqitur dokumentacioni administrativ që kërkon nga PA të pasqyrojnë perditesimin.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi (evidenca 1.3, 1.7) me përmbajtjen (evidenca 1.6) garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë (evidenca 2.21 – 2.29, 5.23). Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi zhvillohet sipas Rregullores së Brendshme të DK, të miratuar me Nr. 27, datë 29/12/2021 (evidenca 1.3) dhe Programit mësimor (evidenca 1.7) ku pasqyrohet përmbajtja dhe dijet që fitohen, krahas aftësive dhe kompetencave të synuara me shpjegimin e cdo lende të programit. Studentet e diplomuar i kanë paraqitur aftësitë e fituara në CV që kanë paraqitur për punësim (evidenca 2.21-2.29, 5.23)			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi ka dokumentacionin mbështetës (evidenca 1.3, 1.7) ku jepet përmbajtja e cila mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Kjo sepse programi është hartuar sipas kërkesave të tregut (evidenca 1.10,) dhe studentet që kanë mbaruar studimet janë ofruar në këto treg duke treguar kompetencat e tyre në CV (evidenca 2.21 - 1.29, 2.35, 5.23).			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Strukturat përgjegjëse UP/ FSHN (evidenca 5.30) dhe DK konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve (evidenca 1.32, 2.36) dhe partnerëve nga tregu i punës me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës (evidenca 5.30).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Përmbushet plotësisht, dokumentuar me evidencat 1.16, 1.18 dhe Tabela 1, 6 ASCAL. Në këto dokumenta Personeli akademik me kohë të plotë apo të pjesshme i angazhuar zotëron së paku një diplomë të ciklit të dytë të studimeve dhe është plotësisht i kategorizuar sipas legjistacionit të sipërpërmendur.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme	Personeli akademik me kohë të plotë (30 antarë) dhe kohë të pjesshme në DK që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin


<p>që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit (11 Prof., 8 Prof. Asoc., 7 Dr., 4 Msc), drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit (Tabela 6, 12 ASCAL).</p> <p>Viti akademik 19-20: 36 PAE (8 Prof; 8 Prof As; 12 Dr; 8 Msc) dhe 21 PAK (3 Prof; 3 Prof As; 8 Dr; 7 Msc)</p> <p>Viti akademik 20-21: 32 PAE (6 Prof; 10 Prof As; 11 Dr; 5 Msc) dhe 17 PAK (3 Prof; 2 Prof As; 5 Dr; 7 Msc)</p> <p>Viti akademik 21-22: 33 PAE (9 Prof; 7 Prof As; 10 Dr; 7 Msc) dhe 13 PAK (2 Prof; 2 Prof As; 5 Dr; 4 Msc)</p> <p>Për realizimin e programit mësimor DK shfrytëzon të gjithë burimet njerëzore, jo vetëm të departamentit të kimisë por të të gjithë departamenteve të FSHN, si dhe të departamenteve përkatëse të vetë UT (përfshirë dhe personel të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar). Kjo gjë vihet re dhe gjatë shqyrtimit të tabelave 12 sipas ASCAL për ngarkesën e orëve në auditor për PS Bachelor në Kimi.</p> <p>Kështu rezultojnë që në këtë program studimi mbi 70 % e orëve në auditor janë realizuar nga stafi akademik efektiv PAE, kjo në përshtatshmëri me kriterin e vendosur nga VKM-nr.-418-date-10.5.2017.</p> <p>Për vitet e fundit kemi respektivisht këto raporte: Për vitin akademik 21-22: 81.46% PAE dhe 18.54% PAK Për vitin akademik 20-21: 77.12% PAE dhe 22.88% PAK Për vitin akademik 19-20: 77.1% PAE dhe 22.9% PAK Për vitin akademik 18-19: 78.37.1% PAE dhe 21.62 PAK</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike- kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Kualifikimi në nivel dhe fushë akademike- kërkimore të përgjithshme dhe specifike të personelit akademik dhe që mbulon programin e studimit është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve dokumentuar plotësisht me evidencën 1.15, 1.16 dhe Tabela 12 ASCAL.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në</p>	<p>Permbushet plotësisht dokumentuar me evidencën 1.12, 1.29, 1.37, 2.36, 2.37 dhe 5.15 -5.16. Labororet dhe mjediset për veprimtari praktike dhe diplomë janë evidentuar në evidencat 1.12, 4.10 ndërsa të dhënat e diplomimit në evidencat 1.3, 2.4.</p> <p>Departamenti i Kimisë ka vënë në dispozicion personelin akademik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës duke zbatuar rregulloren e programit të studimit.</p>

praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	DK ka personel ndihmës akademik 13 antarë me kualifikimin e duhur për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit dokumentuar në evidencat 1.17, 2.38 -2.40. Angazhimi i personelit ndihmës në kualifikime të mëtejshme dhe projekte është paraqitur në evidencat 1.33, 2.41, 2.42 dhe 2.39 dhe Tabela 2 ASCAL.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>UT/FSHN, respektivisht DK kanë hartuar udhëzues të plotë në nivel institucional ku garanton te drejtën e organizimit te veprimtarisë te mesimdhënjes, veprimtarisë kerkimore-shkencore dhe te inovacionit, ne përputhje me standardet e akreditimit te programeve, udhëzuesit e programeve (evidenca 1.1, 2.4, 3.1-3.4) për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies (evidenca 1.12, 4.10) në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p> <p>Metodat e ndryshme dhe inovative te mesimdhënjes jane realizuar përmes dy laboratorëve kushtuar programit te studimit sic jane Laboratori i Metodave Instrumentale te Analizes dhe Laboratori i Kemometrise.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Monitorimi per vlerësimin në mënyrë periodike te aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik eshte i plotë dhe sipas strukturave përgjegjëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UT/ FSHN (evidenca 1.1, 1.2, 1.4, 1.30, 3.5), veçojmë punën e vazhdueshme për Sigurimin e Brendeshem te Cilesise nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë; - Dekanati FSHN (evidencat 3.9, 3.10, 6.11) <p>DK/ përgjegjësi i departamentit kryen vlerësimin periodik (evidenca 1.1, 1.5, 3.7, 3.8, 3.9, 3.10, 6.8, 6.9, 6.10, 6.20, 6.21, 6.24)</p> <p>Statuti i Universitetit te Tiranes, rregulloret e fakulteteve dhe departamenteve dhe ne veçanti per programin e studimit te ciklit te pare bachelor ne Kimi, siguron cileine e brendeshme përmes Komisionit te Perhershem per Sigurimin e Standardeve te Cilesise. Cilesia ne nivelin e programit te studimit realizohet nga Departamenti i Kimise përmes formave si pyetësorë, kontrole dhe analiza, ndërsa përfundimet dhe konkluzionet shqyrtohen ne nivelin e drejtuesve me te larte si dekanat dhe rektorat.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve me pjesëmarrjen e tyre te drejteperdrejte në vlerësimin e lëndëve dhe personelit akademik (evidenca 1.1, 1.14, 6.13-6.19), si dhe në trajtimin e ankimimeve (evidenca 1.5, 2.4).</p> <p>Universiteti i Tiranes i siguron studenteve pjesëmarrjen ne procesin e ankimimit (evidencat 1.1, 6.13, 6.14, 6.15, 6.16, 6.17, 6.18, 6.19), ne Komisionin e Perhershem per Sigurimin e Standardeve te Cilesise (Tabela 24 ASCAL, evidenca 1.30), dhenjen e opinionit per cilësinë e mesimdhënjes dhe vlerësimin e personelit akademik (evidencat 1.1, 6.13-6.19) si edhe kujdestarinë qe ka per mision përcjelljen e cdo problemi qe kane studentet ne organet drejtuese te Fakultetit/universitetit (evidencat 1.1, 1.24).</p>



Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	UT/ FSHN bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të monitorimit dhe të sigurimit të cilësisë për programin e studimit si edhe çdo program tjetër përmes Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës në respektim të kuadrit ligjor (Ligji Nr. 9887 dt. 10/03/2008).			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	DK përmes analizave periodike promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies (evidenca 3.12-3.13, 4.13-4.15, 6.7 – 6.10). Nxitja e DK është realizuar përmes programeve të mobilitetit Erasmus+ që janë në drejtim të kërkimit shkencor apo mobiliteteve për mesimdhënie duke synuar përditësimin e njohurive në funksion të programeve të studimit si edhe sigurimin e një cilësie më të lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Kriteri përmbushet pasi format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër (evidenca 1.5, 1.6, 2.4, 3.14 - 3.18, Tabela 13 ASCAL janë miratuar nga institucioni në përputhje me modelin e dhënë të VKM Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr. 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Personeli akademik pranon dhe respekton diversitetin dhe nevojat e studenteve duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Plotësimi i kriterit është evidentuar me evidencat 1.1, 1.5, 2.4, 3.4, 4.16, 4.8.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible	Mbështetur në evidencat 1.12, 3.2 -3.4 dhe 3.19 – 3.20, UT/ FSHN dhe DK mbështet plotësisht personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe ka mundur përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve potenciale.




pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.									
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Është dokumentuar plotësisht që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie për programin mësimor është kompetent (evidenca 1.15 - 1.18) në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit (evidenca 1.15 dhe Tabelat .								
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi dhe përmirësimi i formave dhe metodave të mësimdhënies (evidenca 1.30) realizohet në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe studentët në këtë proces me reflektimin e mendim te tyre (evidenca 6.13 – 6.10).								
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Personeli akademik i DK ka dokumentuar që përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. Keto metoda zbatohen në auditorë me përdorimin e mjeteve audiovizive dhe interaktive në pasqyrimin e hapave të veprimeve të zgjidhjes apo trajtimit të problemit, në laboratorë me përdorimin e paisjeve dhe aparaturave të analizave kimike dhe në praktikat e zhvilluara jashtë auditorit. (evidenca 1.6, 2.1).								
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Sensi i autonomisë të studentit, në përputhje me udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe marrëdhëniet e respektit të ndërsjellë është siguruar me zbatimin e formave dhe metodave të mësimdhënies. Metoda tradicionale e shpjegimit nga pedagogu me përdorimin vetëm të tabelës, është plotësuar me përdorimin e videoprojektorve si edhe me punën on line përmes MS_Teams. Keto metoda kanë rritur komunikimin pedagog student. (evidenca 2.1, 2.2, 2.4, 3.22, 3.23).								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe	Realizimi i procesit mësimor dhe shkencor të programit të studimit në DK kryhet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht (evidenca 1.12, 1.14, 3.2 – 3.4, 4.8) Raporti

cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	student/sipërfaqe është 26 m ² (Tabela 16 ASCAL, VKM Nr. 418, date 10.5.2017 ku kriteri është 5 m ²).
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	UT/ FSHN, respektivisht DK e zhvillon procesin mësimor në ambiente plotësisht funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor . (evidenca 1.12, 4.16). Nga vizita ne FSHN dhe mjediset e mesimdhënjes per studentet qe ndjekin programin Bachelor ne Kimi, DK zhvillon procesin mësimor dedikuar kryesisht kimisë ne 1374 m2 ku jane vendosur laboratorët e ndryshme per procesin mësimor, preparatorët, disa laboratorë kushtuar kërkimit shkencor si edhe mjaft instrumenta dhe paisje laboratorike bashkohore per programin. Gjithashtu PAE i DK është i paisur me laptope, videoprojektore dhe tabela elektronike per nje paraqitje sa me te efektshme te mësimit dhe prezantimeve shkencore.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Ne UT/ FSHN, respektivisht DK janë krijuar dhe përdoren sisteme të ndryshme informatike, shoqëruar me infrastrukturë të konsoliduar te IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor (evidenca 1.14, 3.2 -3.4, 4.31, 4.8, Tabela 17 ASCAL). Menyra e komunikimit me studentet, rezultatet e arritura ne kolokiume apo vlersime te tjera kryhen përmes këtyre sistemeve duke lehtësuar komunikimin dhe lidhjen student-pedagog. Gjithashtu sistemi i ngritur i IT lejon edhe shfrytëzimin one line te materialeve per studimin jashtë auditorit. Gjate vizitës u demonstrua funksionimi i tyre.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Njohurite e nevojshme të parashikuara në programin e studimit sigurohen plotësisht nga literatura bazë dhe ndihmëse qe është vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) (evidenca 2.1, 4.23, Tabela 14 dhe 17 ASCAL). Ne DK nga PA kjo literature (fizike dhe elektronike) i është vënë ne dispozicion studenteve përmes sistemit te IT. Gjithashtu kjo literature është ndare edhe me Bibloteken e fakultetit duke lejuar qe nje numër gjithnjë e me i madh përdoruesish te kenë qasje.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka e FSHN ku zhvillon veprimtarinë DK garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, me drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor (evidenca 1.29, 4.8, 4.83). Ne bibloteke studentet dhe pedagoget kishin qasje te shpejte, informacioni per literaturën ishte lehtësisht i kërkueshëm dhe fondi i librave dhe revistave te reja pasurohej cdo vit mbështetur ne kërkesën e pedagoqeve.
Kriteri 6. Në funksion të mesimdhënies dhe mesimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të	Personeli akademik i DK dhe studentët aksesojnë tre burime të librarive on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit (evidenca 1.29, Tabela 17 ASCAL) si edhe faqen e vënë në dispozicion nga RASH. Qasja on-line ka mundur qe përditësimi i informacionit shkencor ne përgatitjen e leksioneve, seminareve, etj te jete i shpejte dhe i përdorshëm lehte.



përafërta me programin e studimit.									
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike është dokumentuar plotësisht (evidenca 2.43), ka personel të specializuar ndihmës akademik dhe shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike është dokumentuar plotësisht (evidenca 2.43), ka personel të specializuar ndihmës akademik dhe shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. DK me personelin akademik dhe ndih								
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Personeli akademik i DK përdor platforma on-line (e-learning) dhe këto platforma mbështesin dhe nxisin personelin akademik dhe studentët për përdorimin e tyre (evidenca 3.25). Platforma on-line e cila u provua për efikasitetin e saj sidomos gjatë periudhës së pandemisë, u konsolidua dhe ka mbetur si mekanizëm shtesë për të nxitur procesin e mesimdhënies dhe mësimnxënies si edhe komunikimin me të ngushtë pedagog-student.								
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar të hartuara dhe instaluar në FSHN, respektivisht në përdorim edhe nga DK shfrytëzohen plotësisht nga personeli akademik dhe studentët (evidenca 4.31). Ky sistem i ka lejuar çdo student të ketë e-mailin e vet dhe përmes tij të kryej funksionet e ndryshme si ankesa, regjistrime apo informim.								
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Përmbyllja e programit të studimit Bachelor në Kimi bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar. (evidenca 1.5, 2.4, 5.13).								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	FSHN/ DK në nivel institucional promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, përmes koordinimit dhe bashkërendimit me njësitë e tjera kryesore/ bazë duke zhvilluar aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies (evidenca 6.1 – 6.5, 6.20, 6.21, 6.24).

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 23

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>FSHN/ DK ka përgjegjësi të plote për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofron, përmes sigurimit të buxhetit, kualifikimit dhe trainimeve periodike, tërheqjes së mendimit dhe takimeve periodike (evidenca 1.1, 1.30, 2.30, 3.26, 4.17 – 4.19, 5.29, 6.13 – 6.19).</p>			
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Mbështetja e eksperimentimit dhe zhvillimi i metodave të reja inovative të mësimdhënies është i dokumentuar që realizohet plotësisht nga FSHN dhe njësitë, respektivisht DK në bashkëpunim me njësitë e tjera. (evidenca 1.3, 3.2 - 3.4, 3.19).</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>DK ka dokumentuar plotësisht që personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. (evidenca 1.32 -1.39, 1.4, 2.30, 3.27 – 3.30, 4.11 – 4.15, 4.22, 6.7 – 6.10 dhe Tabelat 4, 19, 20 ASCAL).</p>			
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik i DK trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja (evidenca 1.12, 1.29, 1.32, 2.30, 4.10, 4.30, 6.7 -6.10). DK ka evidentuar në evidencat e mësipërme pjesëmarrjen në trainime, tavolina të rumbullakta, projekte përmes Erasmus, Erasmus+ dhe Erasmus KA107, ku stafi akademik ka përfituar eksperiencën bashkohore.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Përgjegjësia për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhimi për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja është drejteperdrejte në personelin akademik dhe ndihmës akademik të DK (evidenca 1.1, 1.5, 2.4). Ndryshimi i syllabuseve, metodologjia e mesimdhënies dhe përditësimi i literaturës kalon përmes diskutimeve në stafin akademik dhe ndihmës akademik të organizuar në grupet mesimore kërkimore shkencore. Ky proces kryhet sistematikisht dhe është pjesë e detyrimeve akademike të antarëve të DK.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në zhvillim të programit mësimor DK zbaton metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë përmes raporteve periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse (evidenca 1.12, 1.29, 3.2 -3.4, 4.10, 6.18).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	DK, ne rregullore te posaçme dhe të njohura dhe publike për studentët ka përcaktuar kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale (evidenca 1.24, 2.4, Tabela 15 ASCAL).			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	Studentët informohen në fillim të çdo lëndë/ moduli me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit . (evidenca 1.5, 2.1, 2.4.). Ne Rregulloren e UT, miratuar me Nr. 5, date 12.04.2010 dhe e ndryshura me vendimet e Senatit Akademik deri ne vitin 2015, ne nje sere nenesh jane përcaktuar detyrimet dhe metodologjia e vlersimit per DK si edhe studentet (evidenca 1.5), etika e vlerësimit (evidenca 2.1) dhe detajet e procesit te vlersimit (evidenca 2.4) sipas Rregullores se programit te Studimit. Raporti teori/ ushtrime eshte i paracaktuar ne syllabusin e lendes dhe pedagogu njofton studentin paraprakisht per mënyrën e vlerësimit ne fillim te modulit.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Realizimi i vlersimit të njohurive, aftësive profesionale dhe shkencore realizohet në përputhje me programin e lëndës (evidenca 2.1) kur janë dhënë detajet e kryerjes së vlerësimit. Ne syllabusin e cdo lende përcaktohet mënyra e shlyerjes se lendes qe mund te jete provim ose vlerësim i vazhdueshëm. Kodi i etikes i zbatuar per vlersimin eshte nje element i cilësuar dhe i detyrueshëm per zbatim nga pedagogu dhe studenti. DK zbaton Kodin e Etikes te UT, miratuar me vendim Nr. 12. Date 18.04.2011. Zhvillimi i provimit eshte element i shënuar ne syllabus dhe aty përcaktohet mënyra (me shkrim, me goje), diskriminimi (piket, provimi me shkrim si eliminues, nota) dhe mënyra e vlersimit qe tregon përqindjet qe ndikojnë ne vlersimin përfundimtar. Kriteret qe perdoren jane pjesëmarrja dhe aktivizimi, kontrolllet e ndërmjetme, laboratorët, dhe provimi final. Rezultati përfundimtar varet nga këto përqindje dhe eshte individual per cdo syllabus.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	DK realizon gjate gjithë vitit akademik testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale

profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	(evidenca 1.5, 2.1, 2.4, 3.34, 3.35, dhe Tabela 15 ASCAL). Ne programet lendore procesi i testimit dhe vlerësimit të dijeve është pjesë e programuar në vartësi të lendes. Aty është përcaktuar edhe frekuenca dhe sasia dhe mënyra e këtij kontrolli e dokumentuar në evidencat si më sipër. Vlersimi gjithashtu është i larmishëm nga vlersimi i vazhdueshëm (VLV) për lëndet pa provim deri në lëndet me vlerësim me kompleks si seminare, pjesëmarrje dhe provim përfundimtar të lendes. Këto metoda sigurojnë ndërveprimin me studentin për kontrollin e dijeve përgjatë gjithë vitit kalendarik.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UT/ FSHN, dhe DK ka provuar me dokumenta që përdor sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit që eliminojnë format e ndryshme të abuzimit dhe që rrisin transparencën. (evidenca 1.5, 3.2, 3.3, 3.4). Sistemi MS-Teams i përdorur dhe në përdorim siguron që komunikimet elektronike të testimit dhe vlerësimit të sigurojnë objektivitetin dhe transparencën.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	DK, që mbulon programin e studimit, provon plotësisht që ngre komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/ modulit në procesin e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit profesional. (evidenca 1.5, 2.4, 3.36).
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Procesi i vlerësimit të dijeve me shkrim zhvillohet duke ruajtur anonimitetin e studentit me anën e sistemit dhe infrastrukturës që e mundëson këtë proces (evidenca 2.4, 3.3 dhe Tabela 16 ASCAL). Dy metodat e përdorura nga DK për vlerësimin dhe të dokumentuara janë vlerësimi në distancë përmes MS-Teams (në kushtet e pandemisë) dhe vlerësimi me pjesëmarrje në provim ku studenti është vetë i pranishëm fizikisht. Në këto rast fletët e provimeve sekretohen në mënyrë që studenti të jetë anonim për pedagogun dhe që pedagogu të shmangë vlerësimin subjektiv.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Procesi i vlerësimit shoqërohet me komente dhe këshillime që mundësojnë përmirësimin e të nxënës dhe krijojnë mundësinë e përmirësimit (evidenca 1.5, 2.4). Në vlerësimet e ndërmjetme pedagogu kryen shënime sqaruese për të ndihmuar studentin në testimet e ardhshme ndërsa zbatohen konsultimet paraprake duke bërë një përmbledhje të eksperiencave për çfarë duhet pasur kujdes në testim. Kjo zbatohet edhe përpara provimeve si edhe për provimet e prapambetura.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Me mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të vlerësimit të dijeve DK shmang maksimalisht plagjiaturën dhe kopjen (evidenca 1.5, 2.4, 3.3). FSHN dhe DK në menaxhimin e provimeve kujdesen në zbatimin e rregullores së provimit duke shmangur të gjitha mjetet dhe mënyrat që do të favorizonin kopjen. Sallat e përcaktuara për zhvillimin e testeve e lehtësojnë këtë proces pasi krijojnë hapsirë e nevojshme që studenti të realizojë testin në një hapsirë të nevojshme.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive	Kontrolli i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe rezultatet jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse

profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	(evidenca 1.5, 2.4, 3.3). Menyra e vlerësimit dhe koha e përcaktuar janë pjese e rregullores së provimit dhe zbatohen në mënyrë të përpikë. Koha dhe mënyra e vlerësimit lejon që procesi të menaxhojë edhe ankesat dhe keqvlertesimet përmes mekanizmave të nevojshme të përfshira në rregulloret.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Te drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit janë të garantuara nga UT/ FSHN dhe respektivisht me DK përmes rregulloreve përkatëse (evidenca 1.5, 2.4) ku janë përshkruar detajet e procesit. Njohja me vlerësimin dhe ankesa ndjekin një llogjikë që krijon mundësi të sqarimit të paqartësisë në vlerësim brenda DK dhe në rast se kjo nuk arrihet, procesi përfshin Dekanatin deri në rastin ekstrem të ngritjes së një komisioni ad-hoc për rivlerësim.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura e ndjekur për çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga një komision i posaçëm dhe të gjitha hapat dokumentohen dhe pas zgjidhjes arkivohen (evidenca 1.5, 2.4). Rivlersimi me një komision tjetër shmang shkeljen e të drejtës së studentit, të drejtën akademike të vlerësuesve. Evidencat e mësipërme tregojnë qartë dhe hap pas hapi procesin i cili pas zgjidhjes arkivohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit është ndërtuar dhe zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. (evidenca 1.12, 1.6, 1.7, 2.1, 3.23, 3.22 dhe Tabela 13 ASCAL).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit bachelor "Kimi" garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit (evidenca 1.6), humane sociale (evidenca 2.1), komunikimit dhe ndërveprimit (ku përfshihet edhe gjuha e huaj) (evidenca 1.15, 1.6).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, janë përshkruar kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti dhe në përfundim të çdo lënde analizohen e shqyrtohen në mbledhjet e departamentit/ departamenteve. (evidenca 2.1).

Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Ne takimet periodike të DK, në përfundim të çdo lënde/ moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre bazuar në evidencën 2.1.			
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	DK realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit (evidenca 1.29b, 3.14 -3.17, 3.37, 3.20). Mënyrat e realizimit të seminareve apo orëve të hapura realizohet në dy mënyra: one line dhe me pjesëmarrje në auditor. Këto aktivitete realizohen për të ndarë me koleget njohuritë e marra në trajnimet e mobilitetit si edhe në rastin e ditës së hapur për të ngjallur interesein e studenteve të shkollave të larta për studimet universitare.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Programi mësimor/ syllabusi i çdo lënde përmban njohuritë e domosdoshme dhe të mjaftueshme që aftësojnë studentin të zbatojë njohuritë e fituara nga teoria në praktikën në laboratorë dhe praktika profesionale. (evidenca 2.1, evidenca 2.2).			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.	Dokumentacioni mbështetës i DK provon që personeli akademik diskuton dhe punon në grup për interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara. (evidenca 2.1,3.22, 3.23).			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Dokumentacioni mbështetës i DK provon që personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve (evidenca 1.32, 1.4).			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	UT/ FSHN përkatësisht DK mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore (evidenca 1.1, 1.4) dhe i mbështet financiarisht studentët. (evidenca 1.34, 1.39, 4.15, 5.4, 6.10).			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	UT/ FSHN dhe DK me personelin akademik bashkëpunojnë me IAL të tjera për mundësimin dhe rritjen e mobilitetit të studentëve dokumentuar me evidencat 1.33, 1.34, 1.40, 2.31, 2.38, 2.36 dhe Tabela 5, 20 ASCAL).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.8**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	UT/ FSHN, respektivisht DK ka hartuar procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve (evidenca 2.4, 3.39) dhe materialet bëhen publike në internet në faqen e DK.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	UT/ FSHN, respektivisht DK dhe personeli akademik lidhur me programin e studimit asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. (evidenca 1.24, 2.4, 3.39).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Testimi i njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, për të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike vlerësohet nga komisioni i posaçëm i administrimit të provimit final dokumentuar në evidencën 3.39.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Orientimi dhe ndihma për studentët në përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave realizohet nga personeli akademik i DK (evidenca 3.39, 3.40). Ky proces është i pasqyruar në faqen web të DK dhe aty të gjithë antaret e DK njoftojnë temën e diplomës dhe përshkrimin e shkurtër të punimit të saj. Kjo i mundëson studentit të zgjedhë temën në interes të zhvillimit të karrierës së tij të mëtejshme.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Mbështetur në Rregulloren e PS Bachelor në Kimi e paraqitur përmes evidencës 2.4, theksojmë që studimet përmbyllen me provim final për të gjithë studentët dhe jo me punim teze diplome.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Për këtë program studimi nuk aplikohet!

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 29


<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi i provimit ose mbrojtjes së diplomës është me notë (evidenca 2.4, 5.13, 5.24). Vlerësimi i studentit si procedure ndjek rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e diplomimit, ku përmes komisionit të diplomës së ngritur nga DK, piket e cdo antari përcaktojnë vlerësimin përfundimtar. Dhe vlerësimi me pike transferohet në vlerësimin me note që është kalues nga 5-10 në proces verbal të firmosur nga anëtarët e komisionit.</p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Lëshimi i diplomës dhe suplementit bëhet në përfundim të studimeve në bazë të miratimit përkatës nga Ministria e Arsimit dhe me përshkrimin e duhur. (evidenca 1.1, 1.5, 2.4, 2.8, 3.41). Diploma dhe suplementi përmbajnë të gjithë elementet që cilësojnë atë si dokument zyrtar ku përmbahen nënshkrimi i Dekanit dhe Rektorit si edhe vula e Universitetit të Tiranës. Elemente të tjerë që tregojnë cilësinë e përfundimit të studimeve janë edhe certifikatat si Certifikata e Arte (80% të notave 10 dhe pjesa tjetër 9) dhe Certifikata Studenti i Shkelqyer.</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Është e dokumentuar që në përfundim të studimeve, nga UT/ FSHN/ DK studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. (evidencat 1.1, 2.4, 2.8).</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/ konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>UT/ FSHN ruan për një periudhë të pacaktuar sipas legjislacionit, kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/ konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. (evidenca 1.5, 3.42, 3.43, 3.44).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar ne Organigramën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (evidencën 1.14) përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit është Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës.</p> <p>Dega e Burimeve Njerëzore disponon dosje të plota për secilin anëtar të personelit të brendshëm. Nga takimi me DBNJ të fakultetit GVJ u informua që një kopje të dosjes së personelit efektiv depozitohet dhe pranë Sektorit të burimeve Njerëzore dhe Sektorit të Protokoll-Arshivës, pjesë të Drejtorisë së shërbimeve të Brendshme pranë UT.</p> <p>Stafi akademik ripërtërin CV e tij në mënyrë periodike. Evidenca 1.15 paraqet një përmbledhje të CV të stafit akademik efektiv PAE në vitet 2018-2022, CV të përditësuara në nëntor 2021.</p> <p>Mbështetur në Udhëzimit të MASR Nr.29, datë 10-09-2018 i ndryshuar (evidenca 4.2) nga Përgjegjësit e Grup- Lëndëve dhe Përgjegjësi i Departamentit, planifikohet organizimi i kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në veprimtaritë e ndryshme përbërëse, për çdo anëtar të personelit akademik (PAE dhe PAK) (Evidenca 4.1.). Ngarkesa vjetore e personelit akademik), krahas orëve në auditor (ngarkesë e normuar), (leksione, seminare/ ushtrime, seanca laboratorike) (evidenca 4.3), përfshin edhe orë jashtë auditorit si: udhëheqje diplome (evidenca 4.4), udhëheqje doktrature, pjesëmarrje në komisione, (ngarkesë e paguar), përgatitja e materialeve për leksione e seminare, korrigjimet e provimeve etj, konform Udhëzimit të MASR.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura nga RVB dhe takimi me punonjësen e DBNJ, GVJ konstaton që Dega e Burimeve Njerëzore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (DK), për punësimin e personelit ndjek procedurat e përcaktuara në statutin e UT (evidenca 1.1 nenet 7, 14, 67 dhe 68) si dhe në rregulloren e UT (evidenca 1.5 nenet 25; 26) të cilat janë të mbështetura në Kodin e Punës dhe në Statusin e personelit akademik (VKM Nr. 329, datë 12.4.2017). Bazuar në evidencat 4.5 dhe 4.6 vihet re që njoftimi për vendet vakante të punës publikohet në faqen elektronike zyrtare të FSHN.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>DK si njësi bazë e FSHN/UT, për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, bazohet në Statutin e UT dhe rregulloren e UT, për hartimin e kritereve dhe procedurave të rekrutimit të PAE/PAK (evidenca 1.5; për PAE neni 25 dhe për PAK neni 26) dhe procedurat.</p> <p>Bazuar në evidencat 4.5 dhe 4.6 të paraqitura nga RVB dhe informacioni i marrë nga takimi me DBNJ kriteret e punësimit (kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës), dokumentacionin që duhet të dorëzojë aplikanti, si dhe afatet e dorëzimit, për PAE (kur ka vende vakant)</p>



	shpallen publikisht në faqen Web të FSHN dhe në Buletin e Njoftimeve Publike të Agjensisë së Prokurimeve Publike (APP) (evidencat 4.5, 4.6) dhe përzgjedhja e kandidatëve bëhet me konkurs.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Procedurën në lidhje me rekrutimet e reja e ndjek Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori Protokoll-Arshivës së UT në bashkëpunim me DBNJ dhe DPA të FSHN. Për vlerësimin e kandidatëve aplikantë, ngrihet komisioni Ad-hoc (mbështetur mbi statusin e UT neni 67/5) i cili, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të dosjeve (evidenca 1.1 neni 67), bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim (evidencat 1.26).</p> <p>Komisioni Ad-hoc përbëhet nga 5 anëtarë; tre prej të cilëve staf i departamentit, një përfaqësues i dekanatit dhe një i rektoratit : Komisioni Ad-hoc është në përshtatshmeri të plotë me statutin e UT ku shumica është nga DK.</p> <p>Sipas evidencës 1.1 neni 67 pika 7 si dhe nga takimi me punonjësen e DBNJ të FSHN, vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes me dokumentacionin përkatës dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve me dokumentacionin e kërkuar mund t'i nënshtrohen intervistës (evidenca 1.26). Konkurimi zhvillohet në mjediset e Dekanatit të FSHN, ku edhe shpallen kandidatët fitues, shoqëruar dhe me publikimin në faqen zyrtare Web të FSHN (evidenca 4.7).</p> <p>Për rekrutimin e PAK çdo fillim viti, pas planifikimit të ngarkesave, sipas nevojave të DK shpallen vendet në Faqen e web të FSHN/DK. Zyra e DBNJ nxjerr listën e fituesve dhe e dërgon në rektorat.</p> <p>Përzgjedhja bëhet në përshtatshmeri me kriteret dhe specifikat e lëndëve që do mbulohen nga PAK.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacioneve vihet re që përgjithësisht leksionet mbulohen nga personel akademik me kohë të plotë (Evidenca 4.1).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Mbështetur në evidencat e paraqitura nga GVB (evidencat 1.12 dhe 4.10), si dhe vizitat e GVJ në institucion, Departamenti i Kimisë ushtron aktivitetin mësimor dhe detyrat e tij, në 4 godina (evidenca 4.8) të cilat janë godina të rikonstruara me infrastrukturë shumë të mirë. Aktiviteti kërkimor-shkencor zhvillohet në godinat A dhe C ku edhe gjenden laboratorët mësimorë dhe kërkimor-shkencorë (evidenca 4.9). Në funksion të këtij departamenti shërbejnë 16 laboratore mësimore dhe 9 laboratore shkencore.



	<p>Personeli akademik i DK është i okomoduuar në ambiente të pocaçme (evidenca 1.12. 4.10), të cilat janë të pajisuara me mjete të nevojshme për çdo anëtar të stafit akademik. Të gjithë kompjuterat janë të lidhur me rrjet interneti dhe në çdo zyrë ka pajisje për printim-fotokopje.</p> <p>Në kërkesat buxhetore që Departamenti i Kimisë (si pjesë e FSHN) harton çdo vit, parashikohet si zë i posaçëm, blerja e materialeve të konsumit për funksionimin e zyrave (evidence 4.17; 4.18; 4.19).</p> <p>Gjatë vizitës në IAL u kërkua që GVB të paraqiste një projekt buxhet të detajuar i Departamentit të Kimisë meqë evidenca 4.35 paraqiste një përmbledhje për vitin 2019. GVB e ka paraqitur projekt buxhetin e detajuar për 2021, një plan buxhet dinjitoz.</p> <p>Sekretaritetë kishin ambiente të mjaftueshme pune si dhe arkiva e FSHN ndodhet në ambiente të dedikuara.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL dhe dokumentacionit të paraqitur nga GVB vlerësohet që Infrastruktura e FSHN lejon krijimin e një mjedisi pune të përshtatshëm dhe ofron mundësi të barabarta për kryerjen e detyrave dhe aktivitetit mësimor e kërkimor-shkencor të personelit akademik. Pajisa e laboratoreve mësimor me preparatore u jep mundësinë edhe stafit ndihmës akademik, për kryerjen e detyrave në mënyrë profesionale (Stafi ndihmës akademik qenë të pranishëm pranë laboratoreve gjatë vizitave).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës (evidenca 1.2) vihet re që një ndër objektivat strategjike të UT është edhe kualifikimi i vazhdueshëm dhe profesional i personelit akademik. Duke shqyrtuar evidencat e paraqitura nga GVB (evidencat 1.4, 4.27, 3.28), vihet re që kualifikimi i stafit akademik dhe mbështetja për realizimin e aktivitetit kërkimor-shkencor shprehet si në Planin e Kërkimit Shkencor të Zhvillimit të Universitetit të Tiranës ashtu dhe në Planin Strategjik të Departamentit të Kimisë për zhvillimin e programit të studimit (evidenca 1.4). Duke konsideruar evidencën 2.32 vihet re Universiteti i Tiranës në kuadër të programit Erasmus+KAI ka nënshkruar 42 marrëveshje me universitete të ndryshme për periudhën 2016- 2021 dhe për periudhën 2015-vazhdim, ka pasur shkëmbime me rreth 100 universitete të huaja, ku përfshihen mobilitete për studentët, personelin akademik dhe ndihmës akademik (evidenca 2.32). Në faqen zyrtare të web jepet një listë e detajuar e marrëveshjeve bilaterale për periudhën Nëntor 2020 maj 2022 të nëshkruara nga UT. Vihet re një bashkëpunim me 46 institucione arsimore dhe jo vetëm të huaja por dhe brenda vendit. (U kërkua nga GVJ një shëmbull marrëveshjeje me IAL brenda vendit dhe dokumentacioni u paraqit nga GVB).</p> <p>Në faqen zyrtare të web të UT tregohet që Komisioni European i ka akorduar Universitetit të Tiranës logon “HR EXCELLENCE IN RESEARCH”, e cila çertifikon se UT është angazhuar dhe ka krijuar një mjedis pune stimulues dhe profesional për kërkuesit shkencor.</p> <p>Sipas evidences 2.30 në kuadër të programit Erasmus+ KAI apo programeve të tjera, DK, për periudhën 2016-2021, ka realizuar rreth 40 mobilitete.</p>

	<p>Sipas evidencave 2.30; 4.11 dhe 4.12 dhe nga takimi me stafin e DK vlerësohet që mobilitetet e personelit akademik (13) janë kryesisht për kërkim shkencor, trajnime dhe mësimdhënie. Vlen të theksohet që FSHN ka një praktikë të mirë të mbështetjes të veprimtarisë kërkimore-shkencore të stafit akademik në aktivitete të ndryshme shkencore (evidencat 4.13, 4.14, 4.15).</p> <p>Personeli akademik mbështetet financiarisht jo vetëm për pjesëmarrje në konferenca (tarifa regjistrimi), por edhe për akomodime dhe botime të artikujve në revista shkencore prestigjioze (evidencat 1.29/b fq 72 dhe evidencat 1.29/c fq 120; 6.7; 6.9; 6.10). Nga bisedimet gjatë vizitave u theksua që kjo mbështetje planifikohet dhe në buxhetet e DK dhe të FSHN. Departamenti i Kimisë është përfshirë në disa projekte shkencore. Nga faqet zyrtare te web per UT/ FSHN vihet re se në kuadër të programit Erasmus+, DK ka qenë pjesë e projektit NETCHEM (ICT Networking for Overcoming Technical and Social Barriers in Instrumental Analytical Chemistry education), në kuadër, janë realizuar disa workshope me pjesëmarrje edhe të studentëve (evidenca 1.32).</p> <p>Që prej viti 2009, Departamenti i Kimisë është përfshirë në programin e ICP Vegetation (The International Cooperative Programme on Effects of Air Pollution on Natural Vegetation and Crops (ICP Vegetation) i krijuar në vitin 1987 (evidencat 4.13, 4.14, 4.15 si dhe faqja e web-it për DK). Angazhimi i personelit akademik në kualifikimin e tij reflektohet në gradat shkencore apo titujt akademikë të PAE. DK ka në përbërjen e stafit akademik 11 anëtarë me titull akademik “Profesor Doktor”; 8 anëtarë me titull akademik “Profesor i Asociuar”; 7 anëtarë me gradë shkencore “Doktor i Shkencave”; 4 anëtarë Master i Shkencave (Tabelat 1, 4 ASCAL).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin e GVB, vlerësohet se UT ka hartuar në nivel institucional, Udhëzuesin për Programin “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” (Korrik 2021) (evidencat 3.1). Nëpërmjet këtij programi, UT synon të mbështesë Njësitë Kryesore dhe Njësitë Bazë në fushat e kërkimit dhe të inovacionit, nëpërmjet projekteve të financuara nga UT. Rezultatet e kërkimit përdoren më tej në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Duke patur parasysh situatën e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, ku u bë domosdoshmëri mësimi në distancë, në kuadër të metodave të ndryshme të mësimdhënies, UT ka miratuar, udhëzuesin për përdorimin e sistemeve digjitale (evidenca 3.2) i përdorur intensivisht gjatë vitit akademik 2019-2020, 2020- 2021 për të gjitha lëndët e programit Bachelor në Kimi. Udhëzuesi është i shoqëruar edhe nga Rregullorja e posaçme e UT mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve “online” ku gjenden të detajuara mënyra e organizimit të provimeve online, (evidenca 3.3) si dhe nga Manuali për Përdorimin e platformës dixhitale Microsoft Teams (evidenca 3.4). Në kuadër programit evropian për edukim dhe trajnim Erasmus+, për DK vlen të përmendet me të drejtë projekti NETCHEM (evidenca 1.32), synimi i të cilit ishte ngritja e një platforme “online” me qëllim, krahas të tjerash, mundësimin për studentët e universiteteve pjesëmarrëse në projekt të burimeve të hapura të edukimit (si teorike</p>



	<p>ashtu edhe eksperimentale). Ky projekt është finalizuar me ngritjen pranë Departamentit të Kimisë të Labororit-IT (Remote access për Metodën Instrumentale të Analizës, për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies (evidencat 1.12 dhe 4.10). Për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies DK zotëron gjithashtu dhe Laboratorin e Kemometrisë, ci cili ka 12 PC (DTA ANALYZER) (evidencat 1.12 dhe 4.10). Nga takimet me stafin dhe studentët u evidentua që dhe stafi ndihmës është trajnuar dhe ka përdorur metodat inovative, nëpërmjet realizimit të punëve laboratorike në formën e videove për studentët gjatë mësimit online.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas evidencës 4.1, ku paraqitet planifikimi i ngarkesës vjetore (viti akademik 2018-2019), DK organizon punën në funksion të aktiviteteve mësimore e kërkimore- shkencore, duke kryer shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore-shkencore duke u bazuar në kompetencat profesionale të secilit personel akademik si dhe në planifikimit vjetor të kohës së punës. Nga shqyrtimi i tabelave të tipit 12 sipas ASCAL të paraqitura në Aneks vihet re shfrytëzimi i burimeve njerëzore jo vetëm të DK por edhe të UT/ FSHN. Nga shqyrtimi i Tabelës 12 ASCAL vihet re që në mësimdhënie në PS Kimi janë përfshirë personel akademik me kohë të plotë PAE (Akrualisht 30) apo me kontratë PAK të Departamentit të Kimisë si dhe të Departamenteve të tjera si ai i Matematikës, Fizikës, Informatikës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve Universitare si dhe personeli kërkimor i Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ). Duke parë dhe të dhënat e PAK (kualifikimet dhe institucionin nga vijnë) vihet re që personeli akademik është i mirëpërzgjedhur për realizimin sa më mirë të procesit mësimor. Në mbështetje të programit të studimit Bachelor në Kimi, pranë DK-së, janë angazhuar dhe një personel ndihmës-akademik me funksion të sekretares së Departamentit si dhe personel të dedikuar shërbimeve (Organigrama e FSHN evidencia 1.14).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencës 4.8 të nxjerrë nga të dhënat për infrastrukturën e fakultetit, rezulton se FSHN ka në dispozicion të procesit mësimor katër godina me një sipërfaqe të përgjithshme prej 11,863.51 m². Këto godina përmbajnë mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të zhvilluar në mënyrë cilësore veprimtarinë mësimdhënëse teorike dhe praktike të PS Bachelor në Kimi. Godinat</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Page 35




<p>mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>përbëhen nga mjedise zyrash, salla leksioni, seminari, salla laborator, biblioteka dhe ambiente shërbimi etj. Sallat e leksionit dhe seminareve kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 2,559.3 m² dhe laboratorët kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 3492.08 m² (evidenca 4.8).</p> <p>Mbështetur në evidencat 1.12 dhe 4.10 të paraqitura nga RBV si dhe nga vizita në IAL, vërehet se programi i studimit Bachelor në Kimi, shfrytëzon 34 mjedise laboratorësh (19 laboratorë mësimorë, 9 laboratorë shkencorë dhe 8 preparatore) të pozicionuara në godinat A dhe C me një sipërfaqe 1027.5 m².</p> <p>Mjediset e leksionit kanë një kapacitet që varion nga 48 në 150 poste studenti (evidenca 4.8), ndërsa laboratorët kanë mesatarisht 15 poste studenti (evidenca 1.12), në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit (lëndëve dhe punëve laboratorike që zhvillohen në këtë program). Nga shqyrtimi i evidencave 4.8 dhe 1.12 për infrastrukturën FSHN/DK si dhe evidencën 4.8.1 bazuar mbi orarin e tre viteve të PS, lëndëve dhe numrit të studentëve, të gjitha grupet mësimore të programit të studimit Bachelor në Kimi, e kanë numrin e studentëve në përputhje me kapacitetin e sallave ku janë caktuar të zhvillojnë veprimtarinë mësimore. Nga evidenca 1.12 dhe vizita e kryer në ambientet e departamentit të kimisë, vlerësohet se në dispozicion të PS "Bachelor në Kimi", të gjitha mjediset e laboratorëve janë të pajisura me infrastrukturë të përshtatshme, pajisje laboratorike specifike në përshtatje të programit mësimor si dhe sistem aspirimi funksional.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizitat në instiucion vihet në dukje që ambientet për zhvillimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës janë funksionale. Numri i studentëve të planifikuar për të zhvilluar procesin mësimor nuk e kalon numrin e posteve të çdo salle. Një pjesë e auditoreve janë të pajisura me mjetet audio-vizuale të instaluar në mënyrë permanente, ndërsa për pjesën tjetër, personeli akademik zotëron videoprojektorë portabël për pasurimin e metodologjisë së mësimdhënies (evidenca 4.16).</p> <p>Godinat e FSHN-së kanë mundësi për të aksesuar rrjet fiks të internetit, që mund të nevojiten për realizimin e procesit mësimor. Zyrat e stafit, janë të pajisura me kompjutera dhe printerat të cilët janë në përdorim gjatë gjithë procesit mësimor (evidenca 1.12).</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga RBV si dhe nga vizita në instiucion, GVJ konstaton që laboratorët që përdoren për programin e studimit Bachelor në Kimi janë të pajisura me aparaturat, mjetet dhe reagentët e nevojshëm për realizimin e procesit mësimor sipas programeve lëndore. Duke iu referuar evidencave 4.17; 4.18 dhe 4.19 të paraqitura nga RVB në lidhje me buxhetet e FSHN për periudhën 2019-2021, vërehet se janë bërë vazhdimisht investime në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, ku një vend të vecantë zë blerja e paisjeve të reja laboratorike (2019; 2021) dhe mirëmbajtja e këtyre pajisjeve. Bazuar në evidencën 4.9 (foto nga ambientet e laboratorëve) dhe nga investigimi në IAL, laboratorët të DK janë të rikonstruktuar duke u pajisur me infrastrukturë të re dhe me aparaturat të reja (evidencat 4.20, 4.21), për tu mundësuar studentëve</p>



	aftësim teorik e praktik dhe për të arritur objektivat formues të programit të studimit në tërësi.			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Mbështetur në evidencat 1.12 dhe 4.20 të paraqitura nga GVB, si dhe nga vizita në ambientet e DK, vërehet që Departamenti i Kimisë ka ngritur 2 laboratore të dedikuara të teknologjisë së informacionit, të pajisura me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofrohen. <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori-IT (Remote access për Metodatat Instrumentale të Analizës- i ngritur në kuadër të projektit NETCHEM • Laboratori i Kemometrisë 			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Pavarësisht që në programin e studimit nuk është përfshirë praktika profesionale për studentët që kanë interes për praktika dhe internshipe (evidenca 1.29.c fq 16), DK/FSHN ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi tre vjecare me disa Kompani private, IAL dhe Institucione shtetërore dhe vendore, që ofrojnë mundësi për studentët për realizimin e veprimtarive të ndryshme mësimore (evidenca 2.36; dhe evidenca 1.37) si dhe referuar në tabelën 5 ASCAL të aneksit. Bazuar në evidencat 5.15; 5.16 dhe 5.17, të përfuara nga gjurmimi i studentëve rezultojnë se pas përfundimit të programit të studimit Bachelor në Kimi, studentët preferojnë të zhvillojnë internshipe pranë laboratorëve të ndryshëm. Duke konsideruar evidencat 1.12, 4.10, vihet re që Departamenti i Kimisë zotëron 34 laboratorë (përfshirë edhe preparatorët), të cilat përdoren për realizimin e seanceve laboratorike në lëndët: Kimi e Përgjithshme dhe Kimi Inorganike (3 laboratore mësimore; 2 laboratorë shkencorë dhe 2 preparatorë), Kimi Organike (6 laboratorë mësimor, 3 laboratorë shkencorë dhe 3 preparatorë); Kimi Fizike dhe koloidale (4 laboratore mësimore 2 laboratorë shkencorë dhe 1 preparator); Kimi Analitike (6 laboratorë mësimor, 2 laboratorë shkencorë 2 preparatorë; (tek ky grup bëjnë pjesë dhe dy laboratorët e IT së DK). Këto mjedise laboratorike janë të mjaftueshme për realizimin për zhvillimin e veprimtarive praktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmesues	Përmesues pjesërisht	Përmesues kryesisht	Përmesues plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Vizita e GVJ në ambientet e bibliotekës evidenton se FSHN ka në dispozicion të studentëve një bibliotekë dinjitoze. Bazuar në evidencën 4.8.3 të paraqitur nga RVB (rregullorja e funksionimit të BFSHN) si dhe vizita pranë bibliotekës, vlerësohet se biblioteka zotëron katër mjedise (prej të cilëve tre mjedise leximi) (Fondi i Hapur i Librit, Fondi i Hapur i Periodikut dhe Fondi Kryesor i shërbimit me banak si dhe zyra


<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>përgjegjësit-arkiv I literaturës me vlerë të veçantë) me një sipërfaqe të përgjithshme prej 678.75 m² (evidenca 4.8.3) (136 pozicione). Në bibliotekë ka 4 punonjës, 1 prej të cilëve në cilësinë e sekretares së këshillit botues të revistës periodike të Buletinit të Shkencave të Natyrës (evidenca 4.8.3, dhe evidenca 4.22)</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në evidencën 4.23 të paraqitur nga RVB si dhe nga vizita e GVJ në ambjentet e bibliotekës, vërehet se biblioteka e FSHN ofron literaturën fizike të nevojshme për mbulimin e të gjitha programeve të studimit që ofron fakulteti, përfshirë edhe një sërë tekstesh mësimorë të programit Bachelor në Kimi. Meqë evidenca 4.8 paraqet të dhëna për infrastrukture jo fondin e bibliotekës, nga GVJ u kërkua një evidencë për fondin e bibliotekës. Bazuar te kjo evidencë e paraqitur nga GVB vlerësohet se fondi i bibliotekës është i pasur me një numër të konsiderueshëm titujsh, monografish, dizertacionesh e revista shkencore në shqip dhe në gjuhë të huaj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UT/FSHN krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat “online” të fushave të programit të studimit, të cilët kanë mundësi për akses pa pagesë në bibliotekën “online” ULIBRARY. Biblioteka tashmë është pjesë e rrjetit të sistemit bibliotekar e informues COBISS. <i>Bazuar në evidencën shitesë të GVB, për fondin e bibliotekës vërehet se dixhitalizimi i bibliotekës së FSHN është ende në process, deri tani është regjistruar 4.1% e tij.</i> Bazuar mbi Tabelën 17 ASCAL (Aneks), dhe faqeve zyrtare të web si dhe dokumentacionit të fondit të bibliotekës, vlerësohet që UT/FSHN ka finalizuar gjithashtu marrëveshje për qasje edhe në biblioteka të tjera dixhitale si JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM, MSP. Aksesi në to mund të realizohet përmes faqeve “online” të UT dhe FSHN, duke shfrytëzuar adresën zyrtare të e-mail të mundësuar nga Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në ambjentet e bibliotekës, u konstatua se biblioteka e FSHN, vë në dispozicion të studentëve 4 kompjutera, me akses në internet dhe burimet “online”, të vendosur në fondet e hapur, të pajisur me programe kompjuterike për shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Duke marrë në konsideratë evidencat 4.17; 4.18 dhe 4.19 (buxhetet e viteve përkatësisht 2019; 2020; 2021) të paraqitura nga GVB, Universiteti i Tiranës/Fakulteti i Shkencave të Natyrës i kushton një vëmendje të veçantë rinovimit të ambjenteve e pajisjeve dhe pasurimit të fondit të literaturës të bibliotekës. <i>Megjithatë nga takimi me stafin, një nga kërkesat e stafit ishte dhe investim më i madh për paisjen e fondit të bibliotekës. FSHN me literature të kohëve të fundit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve</p>	<p>Duke u bazuar në evidencën 4.8.3 (rregullorja e funksionimit të BFSHN), vihet re që BFSHN ofron shërbimin e saj për studentët dhe</p>



në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	personelin akademik çdo ditë të javës, e hënë-e preme (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit). Nga dokumentacioni shtesë për fondin e bibliotekës vihet re organizimi me një turn gjatë pandemisë dhe me dy turne para pandemisë. Nga takimi me studentët u vu re se ata e shfrytëzuan literaturën e bibliotekës kryesisht për lexim në ambjentet e saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur në materialet e paraqitura nga RVB, dhe vrojtimit gjatë vizitave në IAL, vërehet që sekretaria mësimore e FSHN funksionon duke u bazuar në LAL Nr. 80/2015 dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës, nenet 42, 64 dhe 69.</p> <p>Sekretaria mban kasafortën e saj, në formë të shkruar dokumenta origjinale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar të studentëve (evidenca 3.42) • Regjistrin e arritjeve akademike të studentit (evidenca 3.43) • Regjistrin e lëshimit të diplomave (evidenca 3.44, rregullorja e sekretarisë së FSHN) <p>Sekretaria mësimore arkivon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dosjet e regjistrimit të studentëve, me dokumentacion sipas udhëzimeve të përvitshme të MASR • Procesverbalet e provimeve (evidenca 5.24) • Dosjet e transferimeve prej dhe në programin mësimor (evidenca 1.21, Rast shqyrtimi për transferim studimesh)) • Dosjet e programeve/lëndëve të ekuivalentuara për kategoritë transferim dhe degë të dyta të studimit [(evidenca 1.21 (transferim në degë të dyta): evidence 2.33 (Rast ekuivalentimi për ciklin e dytë të studimeve)] • Statistikat e : studentëve frekuentues; studentëve që e humbasin statusin e studentit si dhe studentëve që ç’regjistrohen • Dosjet e diplomimit <p>Për zhvillimin e procesit mësimor kushtet e pandemisë, UT ka vënë në zbatim platformën e unifikuar dixhitale Microsoft Teams. Nga takimet me studentët dhe nga dokumentacioni rezulton që kjo platformë ka funksionuar mire dhe nëpërmjet saj studentët kanë komunikuar me titullarët e lëndëve në lidhje me seancat laboratorike; literaturën bazë oraret e seancave laboratorike, leksioneve, seminareve, oraret e provimeve, probleme me regjistrimet, notat e provimeve etj (evidencat 4.24; 4.25; 3.25). Bazuar në evidencat 3.2; 3.3 dhe 3.4 për përdorimin e kësaj platforme, UT ka miratuar përkatësisht, udhëzuesin për përdorimin e</p>

	<p>sistemit të mësimin në distance, rregulloren e posaçme “Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve “online” si dhe Manualin për përdorimin e platformës dixhitale. UT/ FSHN u mundësojnë personelit akademik e ndihmës akademik dhe studentëve, në nivel fakulteti dhe nivel universiteti, adresa zyrtare të email-it (evidenca 4.26). Nëpërmjet adresave elektronike, mundësohet aksesin në platformën e integruar Microsoft Teams, platformës dixhitale dhe portalit të studentëve (evidenca 4.31). DK u ofron studentëve informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, përmes këtyre burimeve/ mënyrave:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të institucionit studentët informohen, në lidhje me tarifat e studimit të përditësuara, tarifat për vërtetim student, listë notash, çertifikatë notash, programi studimi shqip dhe anglisht etj., faturat e të cilave printohe ndirekt nga sistemi) • Faqes elektronike të Departamentit • Sistemit MS Teams të cilin e aksesojnë përmes llogarisë personale, me të cilën pajisen në fillim të studimeve në UT, dhe përmes të cilit informohen për kurrikulën e programit, rezultatet e provimeve, etj. • Sekretarisë mësimore • Stendës me informacionet e përditësuara (evidenca 4.30; foto e stendës) <p>Përmes faqes zyrtare në web të fshn dhe nënfaqeve përkatëse, studentët mund të aksesojnë informacione të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri mbi fakultetin në tërësi (historikun, departamentet, programet e studimit, kriteret e pranimit, legjislacionin dhe rregulloret). • Projektet e përfunduara apo në zhvillim nga stafi akademik si dhe aktivitetin shkencor • Specifika të vitit akademik (strukturën akademike, grupet mësimore, orarin mësimor, tarifat e studimit, formularin e vlerësimit të lëndës nga studenti) • Njoftime të ndryshme me tematikë administrative apo akademike etj,
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren për “Funksionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës” (evidenca 4.26), menaxhimi i informacionit dhe i dokumentacionit të pedagogëve, në Universitetin e Tiranës si dhe në Fakultetin e Shkencave të Natyrës realizohet përkatësisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore (SBNj)/Sektori Protokoll-Arshivës (SPA) (https://unitir.edu.al/struktura-organizative/) dhe nga Dega e Burimeve Njerëzore (DBNJ) dhe Dega e Protokoll-Arshivës (Organigrama e FSHN, evidenca 1.14). Bazuar në evidencat 4.27; 4.28 dhe 4.28.1, SBNj/DBNJ disponon dosje të plota, për secilin prej anëtarëve të personelit akademik efektiv (PAE), personelit akademik me kontratë (PAK), personelit ndihmës akademik dhe atë administrativ si dhe procedura e kriteret për punësimin të PAE e PAK. Bazuar në evidencat 4.29 dhe 4.29.1, si dhe nga vizita dhe takimi me punonjësen e DBNJ, vërehet se dosjet personale përmbajnë diplomat dhe listat e notave të njehsuara me origjinalin, CV, si dhe kontratat e punës, procedurat e punësimit dhe dokumenta të tjera që konsiderohen të rëndësishme për punësimin e të gjithë kategorive të punonjësve në UT/ FSHN.</p>



<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga evidenca 4.31, sistemi i menaxhimit/portalit e paraqitur nga GVB përmban informacione rreth programeve lëndore, kurseve, sezoneve të provimeve, oraret e tyre dhe listën e studentëve që janë regjistruar, etj. Çdo anëtar i stafit, personel akademik, ndihmës akademik, dhe sekretaria mësimore kanë akses në llogarinë e tyre personale.</p> <p>Në takimin me studentët, ata pranuan se çdo student i FSHN ka në dispozicion dhe përdor portalin e vet elektronik, me akses personal, ku mund të verifikojë arritjet e tij akademike në mënyrë konfidenciale.</p> <p>Nga faqja zyrtare elektronike e FSHN, studentët mund të printojnë fatura në lidhje me tarifat e studimit, vërtetim student, listë notash, çertifikatë notash, programi studimi shqip dhe anglisht etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Mbështetur në evidencën 4.24 të paraqitur nga RVB si dhe nga takimi me stafin dhe studentët, vihet re se UT/ FSHN ka vënë në përdorim platformën e dedikuar, Microsoft Teams. Siç shihet nga evidenca 4.25 dhe 3.25 të RVB, nëpërmjet kësaj platforme dixhitale janë mundësuar forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të menaxhimit, llogarive personale, platformës dixhitale MS Teams, faqeve zyrtare të IAL (www.unitir.edu.al dhe www.fshn.edu.al) garantohet në kohë reale aktiviteti akademik dhe administrativ i personelit akademik, ndihmës akademik, raportimet individuale, të dhënat mbi organet drejtuese etj.</p> <p>Nga takimi me stafin dhe studentët konfirmohet funksionimi i plotë i këtij sistemi.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqet zyrtare elektronike të Universitetit https://unitir.edu.al/, (UT shqip dhe anglisht) dhe të Fakultetit, https://fshn.edu.al/ (FSHN shqip dhe anglisht), gjenden të publikuara në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe me aktivitetet e ndryshme.</p> <p><i>Vërehet që syllabuset gjenden vetëm në gjuhën shqipe. Mirë do të ishte që syllabuset të ishin edhe në gjuhën angleze.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e</p>	<p>Në evidencën 4.32 të dorëzuar nga GVB paraqet urdhri i miratimit të programit të transparencës, në bazë të të cilit, UT ndër të tjera publikon në faqen e web informacionet/ raportet mbi buxhetin dhe të dhënat financiare.</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 41



<p>programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas evidencave 4.17, 4.18, 4.19, si UT ashtu edhe FSHN publikon buxhetin e tij, i cili pasqyron planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të gjitha ciklet e studimit. Nga GVB citohet evidenca 4.33 por në listën e materialeve të ngarkuara dokumenti gjendet por pa nr dhe nga GVJ u kërkua të paraqitej një document shtesë që paraqiste të detajuar koston e programit. GVB ngarkoi dokumentin e kërkuar i cili vërteton që DK ka të hartuar koston e programit të kimisë së detajuar.</p> <p>Tarifat e shkollimit të miratuara çdo vit nga Bordi i Administrimit (evidenca 4.34) për çdo cikël studimi, si dhe për PS bachelor në “Kimi” nuk e kalojnë tavanin e vendosur nga VKM Nr. 638 datë 22.07.2015 e ndryshuar. Evidenca 4.35 e paraqitur nga GVB paraqet një tabelë përmbledhese të buxhetit të Departamentit të Kimisë.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sipas evidencave 4.17; 4.18 dhe 4.19 të paraqitura nga GVB që paraqesin përkatësisht buxhetet për vitet 2019; 2020; dhe 2021 për UT/FSHN, buxhetet përfundimtare të miratuara nga Bordi i Administrimit përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Miratimin e detajimit të kuotave të buxhetit të konsoliduar (grant mësimdhënie, të ardhura UT) (për FSHN) • Miratimin e detajimit të shpenzimeve operative (për FSHN) • Miratimin e detajimit të investimeve (për FSHN) • Miratimin e numrit të planifikuar të punonjësve. (për FSHN) <p>Nga GVJ u kërkua shtesë një projekt buxhet i detajuar i DK, dokument që u paraqit nga GVJ dhe që tregon që DK harton çdo vit akademik plan buxhetin e tij në funksion të mbështetjes financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e PS.</p> <p>Në projekt buxhete përfshihen zëra për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat "online", përmirësim të infrastrukturës së mjediseve të mësimdhënies (auditoret e leksioneve, sallat e seminareve apo laboratorëve) si dhe rimbursim publikimesh (evidencat 4.13; 4.14. dhe 4.15 të paraqitura nga GVB), të gjitha këto në shërbim të realizimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Referuar faqes zyrtare të UT https://unitir.edu.al/struktura-organizative, vërehet që në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, UT ka të ngritur Sektorin e Auditit të Brendshëm, i cili është nën varësinë e Bordit të Administrimit. Ky sektor i UT kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Në kuadër të programit të transparencës (evidenca 4.32) hartohen raportet financiare të cilat përmbajnë tabelat për të ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare të detajuara.</p> <p>Nga ana tjetër UT/ FSHN është audituar ndër vite nga audit i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike</p>	<p>Në fund të çdo viti nga UT, hartohen raportet dhe analizat financiare, të cilat ruhen në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivë-protokollin (evidenca 4.32).</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 42




dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Në faqen zyrtare te UT paraqiten raportet dhe analizat që përshkruajnë plan-shpenzimet për vitin në vijim dhe të viteve të kaluara akademike. Siç tregohet në evidencën 4.36 e paraqitur nga GVB, për garantimin dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve, në buxhetet afatmesme të UT parashikohen planifikimet dhe ndërhyrjet e posaçme.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Për të arritur objektivate strategjike, si dhe për realizimin e misionit të tij, Bordi i Administrimit i UT mbështetur në kërkesat buxhetore të fakulteteve (evidencat 4.17; 4.18 dhe 4.19) miraton buxhetin përfundimtar të UT (evidenca 4.37). Mbështetur në Tabelën 18 ASCAL, Universiteti i Tiranës garanton qëndrueshmërinë financiare nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Grantit të përcjellë nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit • Të ardhurat nga tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit etj (Problemi i ngritur në takim janë zvogëlimi i nr të studentëve që sjell një rënie të ndjeshme edhe në të ardhurat e FSHN/DK nga regjistrimet dhe tarifat e shkollimit). • Të ardhura nga shërbime të tjera që ofron institucioni. • Sponsorizime. UT ka burime financiare të mjaftueshme për realizimin e objektivate dhe misionit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>PS Bachelor në “Kimi”, ofrohet në përputhje me LAL dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi si dhe aktet rregullatore të nxjerra nga UT.</p> <p>Programi është i organizuar në sistemin ECTS (gjithsej 180 ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 vite akademike.</p> <p>Nëpërmjet politikave, kriterëve dhe procedurave, IAL synon të përzgjedhë për të vazhduar studimet, kandidatët me rezultate sa më të larta. Mbështetur në Statutin e Universitetit të Tiranës (evidenca 1.1) dhe në Rregulloren e Programit të Studimit (evidenca 2.4), nga Senati i UT përcaktohen për çdo vit akademik procedurat e propozimit të kuotave dhe kriterëve për pranimin e studentëve të rinj (evidenca 5.1).</p> <p>Bazuar në statutin e UT, DK përcakton dhe procedurat e transferimit të studimeve (evidenca 1.1/ neni 109) dhe ndjekjes së programeve të dyta (evidencat 1.1/ neni 108, dhe 1.5/ neni 44).</p> <p>Regjistrimi i studentëve bëhet pranë sekretarisë mësimore, ku ata paraqesin dokumentacionin përkatës sipas udhëzimit të përvitshëm të MASR. Në Rregulloren e Programit të Studimit (evidenca 2.4), e shpallur dhe në faqen zyrtare të web të DK, parashikohen të gjitha kërkesat e programit, procedura e diplomimit si dhe elementët mësimorë të programit. Për orientimin e studentëve që nga regjistrimi në program e deri në fund DK ka të përcaktuar detyrat e Kujdestarit Akademik (evidencat 1.1, 1.24 ose faqe web e DK).</p> <p>Nga bisedat me stafin dhe studentët, GVJ vlerëson që personat e përzgjedhur si Kujdestar Akademik janë në dispozicion të orientimit të studentëve të PS.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Duke marrë parasysh evidencën 1.1 nenet 7; 78 dhe 125, vlerësojmë që PS i studimit Bachelor në Kimi është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të lirisë akademike, të drejtave dhe detyrimeve të stafit dhe të studentëve.</p> <p>Në rregulloren e DK (evidenca 2.4 kreu IV), garantohej të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë në UT si dhe për studentët e programit të studimit Bachelor në Kimi.</p> <p>Nga takimet me studentët ata pranojnë që ndihen të trajtuar në mënyrë të drejtë e të barabartë nga DK/FSHN:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët e PS informohen nga Kujdestari Akademik (evidencat 1.1 dhe 1.24 si dhe nga takimi me studentët). • Studentët kanë llogaritë elektronike personale në FSHN/UT, që u mundësojnë akses në platformën Microsoft Teams. • Kandidojnë në Këshillat studentorë dhe përfaqësohen në organet e UT-së dhe njërive kryesore (evidenca 1.1 neni 125 pika 2), (të pranishëm në takim kishte të zgjedhur në këshillat studentore).

	<p>UT ka ngritur në nivel institucional Komisionin për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët (evidencat 1.30 pika 2 dhe 1.31).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët e PS Bachelor në “Kimi” marrin pjesë në aktivitetet shkencore (evidencat 1.32, dhe 5.2) dhe sociale që organizon UT/FSHN (evidenca 5.3). <p>Studentët e pranishëm në takim ishin përfitues të bursave të studimit.</p> <p>E drejta për bursë në FSHN dhe reduktim të tarifës së shkollimit, shprehet dhe në evidencën 1.1 neni 125 pika 6, dhe evidencën 5.4.</p> <p>Bazuar në evidencat 2.4/ neni 20 , evidencën 5.5; dhe evidencën 1.1 neni 22,23 fq 14, 15 dhe neni 125 pikat 4 dhe 11, studentët e këtij PS kanë të drejtë për :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Aplikimit për bursa Erasmus apo bursa të tjera mobiliteti -Ankimimit të vlerësimit në provime -Këshillimit me psikologun e FSHN -Nxitjes së jetës sportive brenda dhe jashtë univesitetit -Si dhe të informacionit nëpërmjet faqes elektronike të FSHN <p>Studentët e pranishëm në takim pranuan që këto të drejta i ushtrojnë dhe nuk janë thjeshtë evidenca.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Kimi (evidenca 2.4) dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës (evidenca 1.5), bazuar në statutin e UT (evidenca 1.1) përcaktohen qartë kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit. Këto dokumente janë të aksesueshme për publikun nëpërmjet faqeve zyrtare të UT, të FSHN dhe të DK.</p> <p>Përveç web-it, plani mësimor dhe programet lëndore u bëhen me dije studentëve në fillim të vitit akademik përmes materialeve, posterave, guidave informuese, etj. (evidencat 5.6, 5.7 Guidat e FSHN).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Në faqet e web të FSHN/ DK gjenden të publikuara kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për programin e studimit Bachelor në Kimi. Përzgjedhja bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar, sipas kriterëve të vendosura dhe në përputhje me aktet e nxjerra nga MASR për këtë qëllim.</p> <p>Për të ndjekur programin e studimit Bachelor në Kimi, studenti duhet të ketë një diplomë të arsimit të mesëm.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>DK, në përgjigje të udhëzimeve përkatëse të MASR, dhe në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, harton kriteret kriterëve të përgjithshme dhe specifike të PS Bachelor në “Kimi” (evidencat 1.23, 5.8) për përzgjedhjen e kandidatëve që do të pranohen në vit të parë, jo më vonë se data 10 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik (evidenca 1.1/ neni 90).</p> <p>Kriteret dhe kuotat (evidenca 1.22) miratohen në Senat Akademik të UT, përcillen në MASR dhe publikohen në portalin ualbania.al.</p> <p>Numri i pranimeve (evidenca 5.9) bazohet në mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (evidenca 5.10).</p>



	<p>Sipas evidencave 1.1; 1.22 dhe 5.11, kuotat e pranimit të studentëve në këtë program studimi, të propozuara prej Departamentit të Kimisë, parashikojnë kuota për kandidatë sipas kategorive më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kandidatët brenda vendit • Kandidatë nga trojet apo kandidatë shtetas të huaj • Kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar ose me statusin e jetimit • Kandidatë romë dhe ballkano-egjiptiane • Kandidatë që aplikojnë për transferim studimesh ose që aplikojnë për program të dytë studimi. 			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UT/FSHN organizon ditët e informimit për nxënësit maturantë.</p> <p>Sipas evidences 5.12 (të marrë nga faqja e web), vihet re që FSHN për studentët e vitit të parë të programit Bachelor në Kimi organizon “Javën orientuese” gjatë së cilës Përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogët e grup-lëndëve të programit udhëzojnë studentët në lidhje me kërkesat e programit të studimit.</p> <p>Në website-in e FSHN gjendet informacion në lidhje me programin e studimit, organizimin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore, si dhe për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në evidencën 2.4 dhe 5.13 paraqiten Rregullorja e Programit të Studimit dhe Rregullorja e Diplomimit në të cilat janë të përcaktuar qartë të gjitha procedurat e përparimit akademik të studentëve të programit të studimit Bachelor në Kimi.</p> <p>Nëpërmjet faqes elektronike të FSHN/DK, studenti merr gjithë informacionin e duhur në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planin mësimor për të tre vitet e studimit • Kërkesat e çdo lënde dhe mënyra e vlerësimit (syllabuset dhe programet lëndore) • Vlerësimin me notë bazuar në pikëve të marra • Sezonet e riprovimeve: periudha dhe kriteret (evidenca 2.4). • Detyrimet për marrjen e diplomës (evidenca 2.4). • Numrin e nevojshëm të krediteve që i duhen një studentit të kalojë nga një viti akademik në tjetrin (evidenca 2.4). • Diplomimin (evidenca 5.13) <p>Informacionin në lidhje me çështjet e sipër përmendura, studentët mund ta marrin dhe nga guida e Fakultetit (evidencat 5.6 dhe 5.7); nga takimet</p>



	<p>e organizuara me Përgjegjësit e Departamenteve (evidenca 5.12) dhe titullarët e programeve lëndore, në çdo fillim viti.</p> <p>Nëpërmjet faqes elektronike dhe guidës së FSHN studenti njihet paraprakisht me planimetrinë e godinave të FSHN, udhëzuesin për përdorimin e postës elektronike, udhëzuesin për orarin dhe emrin e sallave etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në nenet mbi Transferimin e Studimeve dhe Ndjekjen e Programeve të Dyta në Statutin e UT-së (evidenca 1.1/ nenet 108,109 fq 64), në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Kimi (evidenca 2.4/ neni 6 kreu II si dhe në rregulloren e UT (evidenca 1.5 nenet 78-82), përcaktohen qartë kriteret dhe procedurat në lidhje me njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p> <p>Periudha e aplikimit për transferim të studimeve dhe ndjekjen e programeve të dyta bazohet në përcaktimet e MASR para fillimit të vitit të ri akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët vlerësohet se studentët informohen vazhdimisht nga pedagogët e lëndëve mbi vlerësimet gjatë semestrit. Njohuritë e përfituara nga studentët, kontrollohen dhe vlerësohen sipas kriterëve të paraqitura në syllabuse (evidenca 2.1) vlerësim të vazhduar me pikë gjatë semestrit dhe pikët e provimeve me shkrim, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik (evidenca 2.13), të bërë publik nga IAL në faqen zyrtare të web të FSHN.</p> <p>Studentët e DK kanë të drejtë (evidenca 2.4 neni 11 kreu III fq 9) të rishikojnë vlerësimin e tezës dhe të drejtën e ankimimit brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Kimi, në lidhje me procedurën e zhvillimit të provimit apo vlerësimin.</p> <p>Nga bashkëbisedimet me studentët ata pranojnë që e kanë ushtruar plotësisht këtë të drejtë.</p> <p><i>Nga takimi në sekretarinë mësimore GVJ mendon që do ishte më mirë që vlerësimi i vazhduar të përfshihej në të njëjtin proces verbal me atë të provimit përfundimtar.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur në: Statutin e Univesitetit të Tiranës (evidenca 1.1 neni 89 fq 56), Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Kimi (evidenca 2.4 nenet 7-19 Kreu III) dhe Rregulloren e Diplomimit (evidenca 5.13), Departamenti i Kimisë, informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e diplomimit.</p> <p>Të gjithë studentët, informohen për këto kritere nga Kujdestarët akademikë (evidenca 1.24) si edhe nga sekretaria mësimore.</p> <p><i>Vërejmë që studentët e PS bachelor në "Kimi" japin provim diplome të vlerësuar me 4 kredite dhe nuk bëjnë mbrojtje diplome me punim diplome, parashikuar dhe në program.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, para plotësimit të formularëve të aplikimit të maturantëve), UT/ FSHN në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore, organizon ditët e informimit për studentët të ardhshëm. (https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/).</p> <p>Në këto takime, pedagogë dhe studentë të FSHN/DK (evidenca 5.14) me anë të bashkëbisedimit dhe broshurave, u japin informacion maturantëve</p>

studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	se cilat janë përparësitë e programit të studimeve Bachelor në Kimi, mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe punësimit, etj. Në website e FSHN gjenden informacionet ku tregohet që një rol të rëndësishëm në këtë proces ka edhe DSCK që siguron shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nëpërmjet programeve dhe syllabuseve (evidenca 2.1, syllabus sipas modelit të referuar te Tabela 14 ASCAL) institucioni i mundëson studentëve të programit të studimit Bachelor në Kimi, informacion të nevojshëm nëpërmjet të cilit, studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij (evidenca 1.6, Tabela 9 ASCAL) si dhe lëndët që do të zhvillojnë. Studentët njihen me rregulloren e departamentit kimi (evidenca 2.4), e cila informon për mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, diplomimin etj. Gjatë dy viteve të fundit për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, aksesit i këtyre informacioneve, sikurse dhe mësimdhënia janë bërë përmes platformës “online” MS Teams. Sekretaria mësimore, kujdestari i studentëve (evidencat 1.1, 1.24) dhe Dega e IT, asistojnë studentët gjatë gjithë rrugëtimit, nga regjistrimi deri në periudhën e diplomimit (https://fshn.edu.al/info/struktura-administrative) Faqet zyrtare të FSHN/ DK janë aktive dhe nëpërmjet tyre studentët marrin informacion të gjerë dhe të përditësuar mbi rregulloret, zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën etj.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Duke shqyrtuar evidencat 5.6, 5.7 të paraqitura në RVB shihet që FSHN/ DK, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në Kimi, informacione në formën e Guidave të FSHN. Me anë të dokumentacioneve si Rregullore e Programit të Studimit (evidenca 2.4) dhe Programin Mësimor (evidenca 1.6) në dispozicion të studentëve vihet informacioni mbi lëndët, përmbajtjen e programit dhe veprimtaritë formuese, kreditet përkatëse, mënyrën e shlyerjes etj. Informacion i detajuar për studentët, gjendet në faqen zyrtare të Departamentit të Kimisë dhe sistemin elektronik (evidenca 4.26). Studentët mund të marrin informacione shtesë edhe nëpërmjet bibliotekës FSHN/ UT (evidenca 1.1/ neni 28 fq 17).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	Sipas RVB në kuadër të akreditimit institucional (evidenca 1.8), UT ka realizuar studimin e tregut të punës për periudhën 2014-2018 (evidenca 1.9). Tendencat e tregut tregojnë që, studentët që përfundojnë studimet



<p>institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>në Fakultetin e Shkencave të Natyrës kanë një treg të konsiderueshëm pune, mbi 50% e studentëve që kanë përfunduar studimet kanë rezultuar të punësuar (evidenca 1.9), shumica e të cilëve në sektorin privat .</p> <p>Një tregues i mirë për Departamentin e Kimisë, ndër vite, është fakti që ky departament ka punësuar studentë të tij, me rezultate të larta, si staf akademik efektiv (PAE) apo staf ndihmës akademik (evidenca 1.10). Sipas evidencës 1.10, (studimi i tregut e hartuar nga DK), nga pyetësorët e plotësuar ka rezultuar se, studentët që kanë përfunduar studimet e programit Bachelor në Kimi, vazhdojnë studimet në nivelin e dytë dhe të tretë të studimeve pranë Departamentit të Kimisë së të njëjtit Fakultet si dhe një pjesë e tyre edhe në IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit (evidencat 2.20, 2.21, 2.22, 2.23, 2.24, 2.25, 2.26, 2.27, 2.28, 2.29). Gjithashtu studentët të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë dhe të dytë (ose janë duke përfunduar ciklin e dytë të studimeve) punësohen në institucione publike (në administratën shtetërore, në institucione publike të arsimit 9-vjeçar, të mesëm dhe të lartë) dhe në sektorin privat rezultoi (në institucione të arsimit privat dhe në laboratorë të ndryshëm, si dhe në teknologji ushqimore).</p> <p>Nga gjurmimi i studentëve rezulton se, studentët e PS Bachelor në Kimi, pas përfundimit të studimeve, preferojnë të zhvillojnë internship-e pranë laboratorëve të ndryshëm (evidencat 2.29, 5.15, 5.16, 5.17) e më pas studimet në ciklin e dytë të studimeve pranë Departamentit të Kimisë së FSHN apo në Universitete të BE (evidencat 2.22, 2.23, 2.24, 2.25, 2.26, 2.27, 2.28, 2.29), ku mbështeten financiarisht nga universitetet pritëse nëpërmjet programeve të ndryshme si: Erasmus, të realizuara nga marrëveshjet e UT, apo programe të tjera (evidencat 2.21; 2.23; 2.32; 5.18; 5.19; 5.20; 5.21; 5.22 dhe 5.23).</p> <p>UT/ FSHN organizon Panairët e Karrierës (evidenca 5.30). Në këto panairë marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private të cilat ofrojnë ndaj studentëve pozicionet e tyre vakante.</p> <p>UT ka treguar se synon përfshirjen e studentëve në periudha shkëmbimi në Univesitetet partnere të BE. Kjo paraqitet dhe në evidencën 5.30.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Departamenti i Kimisë, përdor burime/mënyra lehtësisht të aksesueshme për tu dhënë studentëve informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij: Këto burime përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Faqen elektronike zyrtare të institucionit për t'u informuar, përditësuar në lidhje me tarifat e: studimit, vërtetimit studentit, listë notash, çertifikatë notash, programi studimi shqip dhe anglisht etj • Faqen elektronike të Departamentit të Kimisë • Sistemin MS Teams, të cilin e aksesojnë përmes llogarisë personale, përmes të cilit informohen për kurrikulën e programit, rezultatet e provimeve etj. • Sekretarinë mësimore • Stendën me informacionet e përditësuara (evidenca 4.30 e paraqitur nga RVB)

<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Nëpërmjet faqeve zyrtare të web të FSHN/DK, (evidenca 5.12; 2.4; 5.6 dhe 5.7 të paraqitur në RVB) studentët, në çdo fillim viti akademik marrin informacion mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, akreditimin programeve dhe të institucionit, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Staf i IT-së në UT/ FSHN ka realizuar Udhëzues e Manualë të posaçëm si dhe Rregulloren e posaçme e provimeve online (e evidentuar edhe në evidencat 3.2; 3.3 dhe 3.4 të paraqitura nga GVB), për të aksesuar platformën dixhitale Microsoft Teams, si dhe për të lehtësuar përdorimin e saj nga studentët në funksion të realizimit të programit të studimit nëpërmjet mesimit në distancë "online".</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Në zbatim të LAL Nr. 80/2015 dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës, (evidenca 1.5 nenet 42, 64 dhe 69), Sekretaria mësimore e FSHN mban në formë të shkruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar të studentëve (evidenca 3.42) • Regjistrin e arritjeve akademike të studentit (evidenca 3.43) • Regjistrin e lëshimit të diplomave.
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore arkivon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dosjet e regjistrimit të studentëve, • Procesverbalet e provimeve (evidenca 5.24) • Dosjet e transferimeve prej dhe në programin mësimor (evidenca 1.21) • Dosjet e programeve të dyta të studimit (evidenca 2.33) • Statistikat e studentëve frekuentues • Statistikat e studentëve që e humbasin statusin e studentit • Statistikat e studentëve që ç'regjistrohen, etj. <p>Të gjithë këto dokumenta mbahen në kasafortën e Sekretarisë mësimore dhe janë material origjinal, nga i cili lëshohen tërë vërtetimet e kërkuara nga studentët, administrata e UT dhe MASR.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Tabelat 23 ASCAL dhe evidencat 6.10; 6.7 dhe 6.9 paraqesin statistikat në lidhje me numrin e studentëve të diplomuar gjatë viteve 2019-2021 në programin e studimit Bachelor në "Kimi".</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes</p>	<p>Të dhënat për ecurinë akademike të studentëve mbahen dhe ruhen korrektësisht nga Sekretaria Mësimore e FSHN.</p>



<p>sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita e kryer nga GVJ pranë sekretarisë mësimore u bënë sondazhe për përputhshmërinë e regjistrit të arritjeve akademike dhe procesverbaleve. Vërejmë se këto të dhëna përputhen me dokumentacionin tjetër të disponueshëm (procesverbale provimesh, riprovimesh, etj). Përveç regjistrave të shkruar sekretaria mësimore, të dhënat e studentëve për programin e studimit i ruan dhe në “database”-in e sekretarisë. Pedagogu i lëndës mban regjistrin individual, si dokument që evidenton dhe vërteton zhvillimin prej tij të orëve të mësimi si dhe frekuentimin e orëve të mësimi nga studenti (evidencat 1.13). Këto të dhëna përdoren në vlerësimin e ecurisë së studentit gjatë vitit si dhe për verifikim frekuentimi për student bursistë, (evidencat 5.4 dhe, 5.25).</p> <p>Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në procesverbale, të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion të pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve. Këto procesverbale, në përfundim të sezonit, pas plotësimit nga pedagogu, depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. <i>GVJ rekomandojmë një rimodelim të proceverbaleve dhe krijimin e një portali për plotësimin e procesverbaleve online.</i></p> <p>Sipas evidencave 3.42 dhe 3.43, si dhe nga vëzhgimi në sekretari gjatë vizitës në IAL, të dhënat e studentëve janë të pasqyruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Arritjeve Akademike të Studentit si dhe në Regjistrin e Diplomave. Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve, të përmendura me lart, menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit, janë të sigurta dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar, ruajnë konfidencialitetin (evidencat 4.31 dhe 4.26/neni 8 fq 6), si edhe garantohet siguria e tyre përmes platformave mbrojtëse (firewall, etj).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Nga evidenca 5.26 (Miratimi nga senati i analizës vjetore 2017-2018) dhe evidenca 6.6 (Hartimi i planit vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore të UT) vërchet që, UT-ja harton Raportin Vjetor me të gjithë elementet përbërës të tij, në zbatim kjo dhe të Udhëzimit të MASR Nr 5, datë 19.02.2018. Duke konsideruar evidencat 1.29 a,b dhe c, si dhe evidencat 6.7, 6.9, 6.10. raportet vjetore të UT hartohen bazuar në evidencat dhe raportet e njëjësive kryesore/ bazë dhe rektoratit, dhe përmbajnë profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Shkalla e cilësisë së punësimit të studentëve (gjurmimi i studentëve) është realizuar nëpërmjet Studimit të Tregut në nivel UT (evidenca 1.9) dhe nivel Departamenti (evidenca 1.10). Raportet janë të shoqëruara me masat/rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimit të cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.</p> <p>Një ndër treguesit e cilësisë së mësimdhënies në analizë është edhe mesatarja e shkollës së mesme tek të regjistruarit në program që është një mesatare relativisht e lartë mbi 8.9 për vitet 2018-2021 (Tabela 21 ASCAL), kalueshmëria dhe cilësia e vlerësimit sipas lëndëve.</p> <p><i>Vërehet një rënie e numrit të studentëve të regjistruar në PS bachelor në “Kimi” (nga 89 në 2018-2019 në 41 në 2020-2021, Tabela 21</i></p>

	ASCAL), si dhe atyre të diplomuar në vite (nga 74 në 2018-2019 në 41 në 2020-2021, (Tabela 23 ASCAL)).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Mbështetur në Statuti e UT (neni 125 pika 1 dhe 2), studentët e Universitetit të Tiranës kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për arsimin e lartë. Studentët përfaqësohen në senatin e Universitetit dhe në 4 komisione si më poshtë (evidenca 1.30):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati Akademik ka 4 anëtarë, përfaqësues të studentëve (evidenca 1.1, Statuti i UT, neni 30) • Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët ka 3 anëtarë (evidenca 1.31), përfaqësues të studentëve (neni 40, statuti i UT, evidenca 1.1) • Komisioni i Përhershëm Për Sigurimin e Standardeve Të Cilësisë ka 3 anëtarë (Tabela 24 ASCAL), përfaqësues të studentëve (neni 41, statuti i UT, evidenca 1.1) • Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës ka 2 anëtarë, përfaqësues të studentëve (evidenca 1.1 statuti i UT, neni 42,) • Këshilli i Etikës ka 2 anëtarë, përfaqësues të studentëve (evidenca 1.1/ statuti i UT, neni 43) <p>Në ambjentet e FSHN kishte ambjent të dedikuar këshillit studentor të fakultetit dhe nga bisedat me studentët këto keshilla ishin funksionale.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në nenin 86 të Rregullores së UT (evidenca 1.5 e paraqitur nga GVB) përcaktohen e drejta e studentëve për Organizimet Studentore. Studentët kanë krijuar këshillat studentore, të cilat zgjidhen çdo 2 vjet, në nivel institucioni dhe njësie kryesore, përmes një procesi zgjedhor të administruar nga KIZS (Komisioni Institucional Zgjedhor i Studentëve) (evidenca 5.27). Studentëve janë pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm (evidencat 5.28, 5.29) duke u përfaqësuar në vlerësimin e programeve akademike si dhe në vlerësimin institucional. Pjesëmarrja reale e studentëve në vlerësimin e procesit akademik evidentohet në procesin e vlerësimit të mësimdhënies përmes pyetësorëve (evidenca 6.13 fq 79-91; evidenca 6.14 fq 302-315; evidenca 6.15 fq 45-53; evidenca 6.16; evidenca 6.17 fq 53-82, evidencat 6.18 dhe 6.19 raport vlerësimi në nivel departamenti. 2018-2019)</p>

<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në hartimin apo ndryshimet e mundshme të programit mbahet parasysh ngarkesa e studentëve brenda dhe jashtë auditorit, duke bërë një shpërndarje të kësaj ngarkese për secilën lëndë, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.</p> <p>Në Statutin e UT (evidenca 1.1 neni 109 fq. 64) dhe në rregulloren e UT (evidenca 1.5 rregullorja e UT neni 78, fq. 37-38) parashikohet njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përfuara në një IAL tjetër, mbi të cilën mbështeten dhe procedurat e transferimeve (evidenca 1.21).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentë si pjesë e komisioneve të përhershme institucionale (evidenca 1.30), kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës (evidenca 1.1), të përmirësimit të programeve të studimit, duke dhënë kështu kontributin e tyre me vlerë. Sugjerimet dhe kontributi i studentëve në nivel departamenti merret gjatë takimeve me Kujdestarët si dhe në plotësimin e pyetësorëve (evidencat 6.13; 6.14; 6.15; 6.16; 6.17; 6.18 dhe 6.19).</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Duke shqyrtuar evidencën 1.5 (nenet 50 dhe 51) dhe evidencën 2.4 përkatësisht rregulloren e UT dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Kimi si dhe nga takimi me studentët themi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studenti ka të drejtë të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit. • Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. <p>Studentët e pranishëm në takim me GJV pranuan që e kanë ushtruar të drejtën e ankimimit dhe kanë marrë zgjidhje dhe mirëkuptim nga Përgjegjësi i departamentit dhe nga stafi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>


Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>DK bashkëpunon me sekretarinë mësimore, kujdestarët akademikë (evidencat 1.1 dhe 1.24), dega e IT, zyrën e financës (shërbimi i bursave) për informimin e studentëve mbi PS, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve dhe afatin e përfundimit, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, pushimet/festat zyrtare, sezonet e provimeve, etj.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>FSHN ka të ngritur Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) strukturë që angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Kjo mbështetje u cilësua dhe gjatë vizitës në IAL. Nëpërmjet faqeve zyrtare të web të FSHN/DK, studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi rregulloret, zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Përmes departamentit, studentëve të programit të studimit Bachelor në Kimi, u ofrohet këshillim/ kujdestari gjatë periudhës së studimeve.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>FSHN ka të ngritur Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës DSBCK, e cila ndërvepron drejtëpërdrejt me studentët për t'i njohur ata me pritshmëritë, kërkesat dhe standartet e tregut, për të përgatitur studentët për prezantimin e parë me punëdhënësin (CV, letër motivuese, intervistë, etj.), orientimin intershipe në institucione të tjera, orientimin në tregun e punës si dhe informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor. Për të ndihmuar studentët në një përjasje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe internship UT/FSHN organizon Panairët e Karrierës (evidenca 5.30), ku marrin pjesë, subjekte publike dhe kompani private, të cilat u ofrojnë studentëve pozicionet e tyre vakante. UT synon të përfshijë studentët në periudha shkëmbimi në univesitetet partnere të BE duke ndihmuar formimin e tyre dhe aftësimin më tej në tregun e punës (evidenca 5.30).</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>DSBCK, në bashkëpunim me Departamentin e Kimisë ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i vë ato në dispozicion studentëve. Kjo tregohet me anë të evidencës 1.10 dhe doli dhe nga takimi me përfaqësuesen e DSBCK gjatë vizitës në IAL.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Duke vlerësuar Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, UT është angazhuar për sigurimin e cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij (evidenca 1.2). Mbështetur në Statutin Universitetit të Tiranës (evidenca 1.1) janë ngritur strukturat për Sigurimin e Cilësisë. Për të arritur këtë qëllim, Senati Akademik i UT ka miratuar Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dhe procedurat për zbatimin e tij (Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Paketën e Instrumentave të Cilësisë) (evidencat 6.1; 6.2; 6.3 dhe 6.4).</p> <p>Nga shqyrtimi i evidencës 1.30 dhe Tabela 24 ASCAL, vërehet se UT ka ngritur gjithashtu strukturat në nivel institucioni, si Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisionin e Kurrikulës etj si dhe Njesitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Njesitë Kryesore (FSHN) (evidenca 1.1).</p> <p>Sipas vendimit Nr. 39 të Bordit të Administrimit, dt. 04.04.2018, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2018”, pika 2, “Miratimi i strukturave për Njesitë e UT-së (evidenca 6.5), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ka ngritur DSBCK, e cila luan rolin e Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel Njësie Kryesore.</p> <p>Nga takimi me përfaqësuesen e DSBCK, nga evidenca 1.1neni 140, fq. 73-74 dhe evidenca 6.8, si dhe faqja e web të FSHN vlerësohet se kjo degë, në bashkëpunim me zyrën e Zv. Dekanit për kurrikulat e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë të Studimeve, organizon pyetësozin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi dhe harton raportet përkatëse.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UT ka ngritur strukturën përgjegjëse të ngarkuar nga Senati Akademik për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit KPSSC. Ajo përbëhet nga 11 antëarë, 8 anëtarë personel akademik dhe 3 anëtarë studentë. FSHN përfaqësohet në këtë komision nga 1 anëtarë personel akademik (evidenca 1.30).</p> <p>Sipas (https://unitir.edu.al/struktura-organizative/) dhe referuar Tabelës 24 ASCAL, UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë, që punon për zbatimin e politikave mbi cilësinë dhe që mbështet me veprimtarinë e saj KPSSC dhe NJSBC në njësitë kryesore.</p> <p>Nga evidenca 1.14 (Organigrama e FSHN) për të siguruar dhe garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm në FSHN, bazuar në vendimin Nr. 39 të Bordit të Administrimit dt. 04.04.20181368 (evidenca 6.5), është ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). DSBCK dhe ka autonomi operative, ka akses në të gjitha të dhënat e Njesisë Kryesore, është në varësi të Dekanit të</p>

	<p>FSHN dhe aktualisht operon me dy punonjës me kohë të plotë, një kryetar dhe një specialist (Tabela 24 ASCAL). Veprimtaria e DSBCK bazohet në evidencat 6.1; 6.2; 6.3 dhe 6.4).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Në dt. 27.10.2018 (evidencat 1.8 dhe 2.9), Universiteti i Tiranës i është nënshtruar procesit të akreditimit periodik institucional të UT-së, që ka rezultuar me vlerësimin përfundimtar pozitiv dhe akreditimin institucional me kohëzgjatje prej 4 vitesh akademike. Në zbatim të vendimit të Senatit Akademik Nr. 26, dt. 21.10.2020 (evidenca 6.6), UT planifikon përgatitjen e raportit vjetor mësimor-kërkimor analizën e programeve të studimit dhe kurrikulave dhe përmirësimin e tyre në masën 20%, përdorimin e dokumentacionit të unifikuar të instrumentave të vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë etj. Për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, UT ka hartuar gjithashtu planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024 (evidenca 6.6.1). Për të mundësuar vlerësimin e brendshëm, FSHN bazuar në tipet e pyetësorëve të ofruara nga paketa e instrumentave (evidenca 6.4), fton studentët online, në mënyrë periodike të plotësojnë pyetësorët për të bërë vlerësimin e lëndëve të programit (evidenca 6.8). DK harton gjithashtu, analizat vjetore të reflektuara në evidencat 6.7, 6.9 dhe 6.10 për periudhën 2018-2021, ku ndër të tjera, përfshihen edhe tipet e pyetësorëve të realizuar gjatë vitit akademik dhe konkluzionet përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sipas evidencës 1.1, në Statutin e Universitetit të Tiranës, kreu X, nenet 138-141, janë përshkruar qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Gjithashtu UT ka hartuar Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, ku janë përcaktuar procedurat, afatet instrumentat dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë (evidenca 6.3). Në kuadër të përmirësimit të cilësisë DK, harton pyetësorë periodikë dhe realizon në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij (evidencat 6.7; 6.9 dhe 6.10).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin</p>	<p>Siç tregohet dhe në evidencën 1.30 dhe në Tabelën 24 ASCAL për monitorimin dhe mbështetjen e programeve mësimorë në nivel institucioni, UT ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të</p>

<p>e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Kurrikulës. Për të garantuar sigurimin e cilësisë së programeve të studimit të ciklit të parë, në nivel Njësie Kryesore është ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (evidenca 6.5). Në kuadër të monitorimit, shqyrtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të programeve të studimit të ciklit të parë, DK bashkërendon punën me Zv/ dekanët dhe përpilojnë Raportet Vjetore të Njesisë Kryesore (evidenca 1.29) të hartuara në bazë të analizave vjetore të Njesive Bazë (evidencat 6.7; 6.9 dhe 6.10).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • FSHN/DK shqyrton programet e studimit nëpërmjet raporteve vjetore të veprimtarisë institucionale të UT (evidencat 5.26 dhe 6.6) si dhe raportet vjetore të fakultetit/departamentit (evidenca 1.29) të cilat analizojnë procesin mësimor kërkimin shkencor. • Departamenti i Kimisë (mbështetur në legjislacionet në fuqi) ka ndjekur procedura standarde për ndryshime në programin e studimit Bachelor në Kimi (evidencat 2.19 dhe 2.34). • FSHN/DK organizon në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve, plotësimin i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies, për lëndët e çdo programi studimi dhe në përfundim të tij hartohet dhe zbatohet një plan masash, për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore (evidencat 6.11 dhe 6.12).
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>UT ka të njehsuar pyetësorët e parashikuar në paketën e instrumentave (evidenca 6.4), të cilat realizohen nga DBSCK në bashkëpunim me Dekanatin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në përfundim të çdo semestri; pyetësori “Vlerësimi i lëndës nga studentët” (evidenca 6.4), i aksesueshëm, nëpërmjet faqes zyrtare të web të FSHN, vetëm nga studentët që kanë llogari elektronike aktive të FSHN. • Gjatë sezonit të diplomimit në muajin Korrik realizohen dy pyetësorë: Pyetësori i parë, “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” (evidenca 6.4), në lidhje me cilësinë e programeve të studimit dhe pyetësori i dytë “Raport i studentëve” (evidenca 6.4), ku studentët e diplomuar të japin përshtypjet/vlerësimin e tyre në lidhje me cilësinë e arsimimit në FSHN/UT. • Në përfundim të çdo semestri, parashikohet pyetësori “Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu” (evidenca 6.4), ku secili anëtar i personelit akademik bën një vetvlerësim/analizë të lëndëve ku janë titullarë, bazuar në përqindjen e kalueshmërisë të studentëve dhe shpërndarjes së notave në përqindje. <p>Pyetësorët e realizuar paraqiten si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statistika në nivel programi studimi (evidenca 6.13) • Statistika në nivel lëndësh për programet e studimit (evidenca 6.14) • Raport mbi pyetësorin: “Vlerësim i studentëve që diplomohen” (evidenca 6.15) • Raport mbi pyetësorin: “Raport i studentëve” për vlerësimin e programeve të studimit, (pyetësor në letër, jo online) (evidenca 6.16). • Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu (evidenca 6.17)




	<ul style="list-style-type: none"> • Raport mbi pyetësin: “Për vlerësimin e mësimdhënies “online””, (evidenca 6.18). • Raporti i vlerësimit të lëndëve nga studentët, (evidenca 6.19). Senati Akademik të UT me Vendimim Nr.51, dt. 23.12.2020 ka miratuar Manualin e Cilësisë, Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në UT, si dhe Paketën e Instrumentave (evidenca 6.1). Të gjitha këto shërbejnë si instrumente të rëndësishëm për FSHN/DK për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore. 								
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në fund të çdo viti akademik, Departamenti i Kimisë harton analizat vjetore (evidencat 6.7, 6.9, 6.10) të cilat përdoren më tej për raportet vjetore në nivel fakulteti (evidenca 1.29).								
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>Analizat vjetore në nivel departamenti (evidencat 6.7, 6.9, 6.10) dhe raportet vjetore në nivel fakulteti (evidenca 1.29) përmbajnë vlerësimin e mbarëvajtjes së programeve të studimeve, me elementët matës të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i studentëve të regjistruar për çdo vit akademik • Numri i studentëve të diplomuar për çdo vit akademik • Studentë të shkëlqyer • Studentë të çregjistruar • Plotësimi i standarteve të stafit akademik/artikuj të botuar, pjesëmarrjet në konferenca, projekte etj. • Sponsorizimet për konferencat dhe artikujt <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i standarteve të ambienteve/didaktikës laboratorike (përmirësimi i strukturës laboratorike) • Përqindja e kalueshmërinë dhe përqindja e të diplomuarve • Ngarkesa mësimore e personelit akademik • Konkluzionet e pyetësorëve të studentëve të cilat hartohen në raporte analitike të detajuara nga DSBCK. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës bën të njohura raportet e saj vjetore bërë publike në faqen elektronike të FSHN. Përmirësimin të cilësisë së programeve, në UT/ FSHN u shërben dhe Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik (evidencat 6.20 dhe 6.21), si dhe Rregullorja “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” e miratuar në parim (evidenca 6.22). 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Pjesë e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit “Bachelor” në “Kimi” janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizat vjetore të hartuara në nivel Departamenti (evidencat 6.7, 6.9, 6.10), dhe raportet vjetore në nivel Fakulteti (evidenca 1.29 a, b dhe c), të cilat më tej përdoren për raportet vjetore në nivel universiteti. • Raportet/analizat e përvitshme të pyetësorëve (evidencat 6.13, 6.14, 6.15, 6.16, 6.17, 6.18, 6.19), të hartuara dhe realizuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës • Raportet vjetore të DSBCK. (faqe zyrtare web FSHN)
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit, UT ka miratuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dhe procedurat për zbatimin e saj (evidencat 6.1, 6.2, 6.3, 6.4) • Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik (evidencat 6.20 dhe 6.21) • Miratimi në parim i Rregullores “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” (evidenca 6.22) • Krijimin e DSBCK (evidenca 6.5 dhe https://fshn.edu.al/Info/dega-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-dhe-karrieres) <p>Të gjitha këto instrumenta IAL i përdor për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit që ofron.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>FSHN/DK, në kuadër të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programeve të studimit, përdorin këto metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Kimisë harton Analizat Vjetore (evidencat 6.7; 6.9 dhe 6.10) të cilat vlerësojnë mbarëvajtjen e PS, në gjithë elementët matës si tek kriteri 5 i standartit 6.2, të cilat raportohen më tej në raportet vjetore të FSHN (evidenca 1.29 a,b,c) • Në raport e paraqitur nga GVB cilësohet “Çdo vit akademik realizohen ndryshimet në masën 20% të planeve mësimorë” të dokumentuar në evidencat 2.19 dhe 2.34. <p>Nga takimi që patëm me GVB dhe me stafin e DK arritëm në konkluzionin që ndryshimet deri në masën 20% bëhen kur shihet e nevojshme nga vlerësimet e pyetësorëve; vlerësimet e kërkesave të tregut; nga nevoja për të përfshirë në programe arritje të reja në disiplinat përkatëse si dhe në kuadër të modernizimit për t’iu afruar programeve të ngjashme ndërkombëtare, duke marrë në konsideratë dhe përvojën e stafit gjatë kualifikimeve jashtë vendit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolle nga dekanati mbi zhvillimin e procesit mësimor (evidencat 3.7 dhe 3.8) • DSBCK realizon pyetësorët e përvitshëm dhe harton analizat përkatëse (evidencat 6.13; 6.14; 6.15; 6.16; 6.17; 6.18 dhe 6.19) • DSBCK harton raportet vjetore mbi vlerësimin e cilësisë, (evidenca 6.23) dhe i bën ato publike në web.




	<ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësit e Departamenteve, në bashkëpunim me Titullarët e Grup-Lëndëve (evidenca 2.10) mbikqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera të zhvillimit të programit. • Performanca e stafit akademik (evidencat 3.11) 			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>FSHN/ DK në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metodat dhe instrumentet të tërthorta vlerësimi si më poshtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësi “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” (evidenca 6.15) • Studimin i Tregut në nivel institucional (UT) (evidenca 1.9). • Hartimi i një raport të hollësishëm mbi tregun e punës për studentët e diplomuar në UT, përfshirë edhe studentët e FSHN. • Studimin e tregut të punës nga DK (evidenca 1.10) duke tërhequr në këtë mënyrë mendimin e studentëve të diplomuar. • Realizimi i pyetësorit në fund të çdo semestri “Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu” (evidenca 6.4 dhe 6.17), ku personeli akademik jep më tej mendimin e tij kritik për lëndët dhe ndryshimet në përputhje me standardet dhe kërkesat e ASCAL. • Sipas Rregullores “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” (evidenca 6.22 neni 7), personeli ndihmës akademik dhe administrativ në UT përfshihet në procesin e vlerësimit të programit. <p>Nga shqyrtimi i rezultateve të studimit të tregut të organizuar nga UT (evidenca 1.9) për fakultetin e shkencave të natyrës shqyrtimi i raportit për studimin e tregut të punës nga DK na rezultoi:</p> <p><i>-Një pjesë e madhe e ish studentëve të pyetur e shohin si problem mungesën e praktikës profesionale (një mungesë e tillë vihet re në vazhdimësi dhe në PS Bachelor në Kimi)</i></p> <p><i>-një pjesë e papërfillshme ka gjetur punë me ndihmën e zyrës së karrierës (vetëm 3%)</i></p> <p><i>-Nevoja e funksionimit më mirë të zyrave të karrierës për mundësinë e lidhjeve të studentëve me sektorë të ndryshëm që mund të punësojnë studentët.</i></p> <p>Nga takimi me përfaqësuesen e DSBCK u pranua që pjesmarrja e studentëve në plotësimin e pyetësorëve online është relativisht e ulët. Gjithashtu në këtë takim u theksua dhe nevoja e organizimit më të shpeshtë të panairëve të karrierës për krijimin e kontakteve të studentëve me të interesuar për punësimin e tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Neni 7 pika 3 e Statutit të UT (evidenca 1.1), thekson se, nëpërmjet lirisë akademike, autonomisë financiare dhe organizative, UT lidh marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore shkencore, kualifikuese, inovative, duke mundësuar kështu përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Edhe në strategjinë e zhvillimit të UT 2018-2024 fq 4 theksohet që UT për sigurimin e cilësisë për programet që ofron, do t'i kushtojë rëndësi marrëveshjeve të bashkumimit me IAL të vendit dhe të huaja.</p> <p>Në kreu X, nenet 138-141 të statutit të UT (evidenca 1.1), në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përshkruhen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të UT (evidenca 6.3) janë përcaktuar procedurat, afatet instrumentat dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në evidencën 1.30 studentët janë të angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet përfaqësimit në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, me 3 anëtarë (Tabela 24 ASCAL), mbështetur në neni 41, statuti i UT, (evidenca 1.1). • Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, me 2 anëtarë, përfaqësues të studentëve (neni 42, statuti i UT, evidenca 1.1). <p>Gjithashtu studentët angazhohen në vlerësimin e programeve akademike si dhe në vlerësimin institucional si pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm (evidencat 5.28, 5.29).</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Njesia Kryesore, FSHN ka përfaqësuesit e saj në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës (evidenca 1.30, Tabela 24 ASCAL). Në nivel Njesie Kryesore, për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë së programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, është ngritur (DSBCK) (evidencat 1.14 dhe 6.5) e cila luan funksionin e Njesisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti. Në nivel Njesie Bazë, DK ka përfaqësuesit e tij në Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës (evidenca 1.30 dhe Tabela 24 ASCAL) dhe Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik (evidenca 1.30).</p> <p>Studentët janë të përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë së programit mësimor nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketimeve periodike nga DSBCK • Marrjes së mendimeve dhe propozimeve nga Këshilli Studentor • Takimeve me Kujdestarët e programit.

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe <i>evidenca 6.24</i>, vlerësimi i cilësisë së programit të studimit, realizohet nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime duke ruajtur konfidencialitetin e tyre dhe duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut e punës, nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni, UT/FSHN organizon Panairt e Karrierës (<i>evidenca 5.30</i>). Në këto panairre marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private të cilat i ofrojnë studentëve pozicionet e tyre vakante dhe japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Gjithashtu, në këtë kuadër, në bashkëpunim me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme si dhe me delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri UT ka realizuar aktivitetin “Java e Europës në Universitetin e Tiranës” (<i>evidenca 5.30</i>), duke synuar përfshirjen e studentëve në periudha shkëmbimi në univesitetet partnere të BE duke ndihmuar aftësimin më tej në tregun e punës si dhe fitimin e eksperiencave në funksion edhe të përmisimit të programeve mësimore.</p>			
<p>Sikalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, sahet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në faqet zyrtare të web (në nënfaqet përkatëse), në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UT/FSHN bën transparente dhe publike, , për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për të gjitha programet e studimit. Në këtë kontekst, UT ka krijuar programin e transparences, i cili është publik në linkun https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/. UT/FSHN ofron transparencë dhe publikon nëpërmjet postimit në faqen elektronike zyrtare të fakultetit/universitetit, -Analizën e Pyetësorëve -Statutin e UT -Rregulloren -Vendime të Senatit Akademik -Vendime të Bordit të Administrimit aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë etj.</p>



<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga UT/FSHN/DK, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 531, dt. 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, janë përpiluar raportet e analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies (evidencat 6.13; 6.14; 6.15; 6.16; 6.17; 6.18 dhe 6.19). Informacioni i publikuar në raporte, respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr.9887 dt. 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga evidencat 6.11 dhe 6.12 vërehet se Departamenti i Kimisë ka hartuar planin e masave për të gjithë tipet e pyetësorëve të realizuar dhe ka adresuar dobësitë apo mangësitë e evidentuara në raportet analitike duke synuar përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në strategjinë e zhvillimit të UT (evidenca 1.2), theksohet se një prej objektivave të tij është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programeve të studimit. Në Planin e Masave të hartuar nga DK (evidencat 6.11 dhe 6.12), për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit, parashikohet shtimi i pajisjeve të reja laboratorike, forcimi i lidhjeve me biznesin dhe industrinë për studentët që dëshirojnë të zhvillojnë praktikatat profesionale, rishikimin e orëve laboratorike për lëndët me karakter praktik, shtimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Me qëllim ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit, FSHN/DSBCK, në bashkëpunim me Këshillin Studentor, organizon aktivitete dhe leksione informuese. (faqe zyrtare e web FSHN dhe nënfaqe e DSBCK).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Kimi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Programi i studimit Bachelor në Kimi, në nivel kombëar është një program unik, i konsoliduar, me një eksperiencë shumë vjecare, dhe i strukturuar në përshtatshmëri me tregun e punës.
2. Departamenti i kimisë përbëhet nga një staf me kualifikim të lartë dhe me një përfaqësim të mirë të brezave, që garanton vijimësinë e cilësisë së programit. Një pjesë e mirë e stafit janë specializuar në institucione prestigjioze të huaja.
3. Infrastruktura laboratorike e pajisur me aparatura bashkëkohore si dhe pjesëmarrja e departamentit/ fakultetit në projekte kërkimore– shkencore reflektohet në botime të shumta dinjitoze të stafit. Pozitive është dhe mbështetja që fakulteti jep për sponsorizime të stafit për pjesëmarrje në konferenca dhe për botime në revista të indeksuara shkencore.
4. FSHN ka dhe revistën e vet shkencore që ndihmon në promovimin e punimeve shkencore sidomos të të rinjve.
5. DK/ FSHN ka marrëveshje me institucione publike dhe private për realizimin e intershipeve nga studentët dhe për mundësinë e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve.
6. FSHN zotëron një bibliotekë të pajisur me një fond të konsiderueshëm teksesh dhe materialesh në ndihmë të realizimit të PS. Biblioteka e FSHN ka marrëveshje për qasje edhe në biblioteka të tjera dixhitale.
7. Në kuadër të projekteve të përbashkëta shkencore FSHN/ DK në bashkërendim me rektoratin e UT realizon vazhdimisht marrëveshje me universitete të huaja për mobilitete të stafit dhe të studenteve dhe bashkëpunime shkencore.
8. Me qëllimin që PS të përshtatet me kërkesat e tregut dhe të jetë sa më i afërt me PS të ngjashme në universitete të huaja partnere, DK kryen vlerësime periodike të nivelit të programit të studimit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe bën përmirësime në programet lëndore mbështetur në legjisllacionin në fuqi.

Pika të dobta:

1. Programi i studimit nuk plotëson vlerësimet në kredite për tipologjitë e lëndëve në përmbushjen e kërkesave të VKM 41. dt. 24.01.2018. (**Standardi II.3, kriteri 2**)
2. Një studim më i thelluar i tregut të punës dhe gjurmimi i punësimit të studentëve pas mbarimit të studimeve për të mundësuar punësimin e tyre në përshtatshmëri me diplomën. (**Standardi VI.3, kriteri 4**)
3. Numri në rënie i studentëve kërkon një promovim më të mirë të programit në mënyrë që të ruhet cilësia e studentëve që regjistrohen në PS Bachelor në “Kimi”. (**Standardi V.4, kriteri 5**)

Rekomandime:

1. Duhet të rishikohen vlerësimet në kredite për tipologjitë e lëndëve deri në përmbushjen e kërkesave të VKM 41. dt. 24.01.2018.
2. Institucioni, të rrisë mobilitetin e studentëve me qëllim ndërkombëtarizimin e programit të studimit.
3. Departamenti i Kimisë të rishikojë procedurat e diplomimit të studentëve të PS Bachelor në “Kimi”, në përshtatshmëri me Statutin dhe Rregulloren e UT, për t’u dhënë mundësinë studentëve të ekselencës së këtij programi studimi të zhvillojnë tema diplome.
4. Në programin e PS Bachelor në “Kimi” nuk përfshihet praktika profesionale. Ndonëse programi përfshin një numër të konsiderueshëm orësh laboratorike, në lëndë të veçanta mund të planifikohen vizita në institucione, laboratore apo dhe në industri, duke shfrytëzuar marrëveshjet e FSHN/ DK. Kjo që dhe një kërkesë e studentëve në takimin me GVJ.
5. Vërehet që syllabuset gjenden vetëm në gjuhën shqipe. Sugjerojmë që syllabuset të jenë edhe në gjuhën angleze.




Conclusions of the Evaluation of the Bachelor Study Program in "Chemistry" of the Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths and affirmations:

1. The Bachelor in Chemistry study program at the national level is a unique, consolidated program with a multi-year experience, and structured inadaptability to the labor market.
2. The chemistry department consists of a high-qualification staff and a good representation of generations, which guarantees the continuation of the quality of the program. A good part of the staff specialize in prestigious foreign institutions.
3. Laboratory infrastructure equipped with contemporary equipment as well as department/faculty participation in research–scientific projects is reflected in numerous dictating staff publications. The positive is also the support the faculty gives for staff sponsorships for participation in conferences and for publications in scientifically indexed journals.
4. FSHN also has its own scientific journal that helps promote scientific works especially for young people.
5. DK/FSHN has agreements with public and private institutions for the realization of student interviews and for the possibility of employing students after completing studies.
6. FSHN owns a library equipped with a considerable fund of texts and materials in aid of the realization of the PS.
7. Within the framework of the joint scientific projects FSHN/DK in co-ordination with the UT rector, agreements with foreign universities are constantly carried out for staff and student mobility and scientific collaborations.
8. With the aim of the SP adapting to market demands and being as close as possible to similar PS at foreign partner universities, DK conducts periodic assessments of the level of the study and quality of teaching program and makes improvements to legal programs based on the legislation in force.


Weaknesses:

1. The study program does not meet credit assessments for subject typology in meeting the requirements of DCM 41 date 24.01.2018. **(Standard II.3, criteria 2)**
2. A more deepened study of the labor market and the tracking of student employment after completing studies to enable their employment in adequacy with the degree. **(Standard VI.3, criteria 4)**
3. The declining number of students requires better promotion of the program in order to preserve the quality of students who enroll in the Bachelor's PS in "Chemistry". **(Standard V.4, criteria 5)**



Recommendations:

1. Estimates in credits for subject typology should be reviewed to meet the requirements of DCM 41 date 24.01.2018.
2. The institution, increase student mobility with the aim of internationalizing the study program.
3. Department of Chemistry must revise the graduation procedures of SP Bachelor in "Chemistry", in accordance with the Statute and Regulation of UT, to give excellence students of this study program, the opportunity to develop diploma theses.
4. The Bachelor's PS program in "Chemistry" does not include professional practices. Although the program includes a considerable number of laboratory hours, visits to institutions, laboratories or industry can be planned in particular subjects, using FSHN/DK agreements.
5. It is noted that syllabuses are found only in Albanian. We suggest that the syllables are also in English.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

